

Analiza e zhvillimit dhe planifikimit të qëndrueshëm të transportit në RMV në aspekt të ndikimit në ndryshimet klimatike

Shkup, 2023

Analiza e zhvillimit dhe planifikimit të qëndrueshëm të transportit në RMV në aspekt të ndikimit në ndryshimet klimatike

Titulli origjinal

Анализа на развојот и одржливото планирање на транспортот во РСМ од аспект на влијанието врз климатските промени

Botues

Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë

Projekti

Organizatata civile në veprim për klimën

Implementues

Qendra për hulumtim dhe informim për mjedisin jetësor "Eko-svest" nga Shkupi, Shoqata maqedonase e juristëve të rinj (SHMJR) dhe Organizata lidhja e vlerave natyrore dhe njerëzve – CNVP

Autorë

Prof. Dr. Beti Angjelevska dhe Zharko Haxhi Zafirov

Redaktore

Bojana Bozhinovska Siljanovska

Redaktimi gjuhësor

Eleonora Stojkoska – Popetrevska

Përkthimi nga maqedonishtja në shqip

Rexhep Xheladini

Design

Haris Muriq

Shkup, 2023

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

656:504.7]:502.131.1(497.7)

ANGJELEVSKA, Beti

Analiza e zhvillimit dhe plani (преовладување ит) të qëndrueshëm të transportit në RMV në aspekt të ndikimit në ndryshimet klimatike) [Електронски извор] / [autorë Beti Angjelevska dhe Zharko Haxhi Zafirov ; përkthimi nga maqedonishtja në shqip Rexhep Xheladini]. - Shkup: Shoqata e juristëve të rinj të Maqedonisë, 2023

Начин на пристапување (URL):

<https://myla.org.mk/wp-content/uploads/2023/06/Analiza-e-zhvillimit-dhe-planifikimit-te-qendrueshem-te-transportit-ne-RMV-ne-aspekt-te-ndikimit-ne-ndryshimet-kl.pdf>.

- Превод на делото: Анализа на развојот и одржливото планирање на транспортот во РСМ од аспект на влијанието врз климатските промени. - Текст во PDF формат, содржи 69 стр., илустр.

- Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 16.06.2023. - Библиографија: стр. 68-69. - Содржи и: Анекси 1. - Organizatat civile në veprim për klimën

ISBN 978-608-4843-81-8

1. Haxhi Zafirov, Zharko [автор]

а) Транспорт -- Стакленички гасови -- Одржлив развој -- Анализи -- Македонија

COBISS.MK-ID 60702981



Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë ato të autorëve të kësaj analize dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe opinionet e donatorit dhe të Qeverisë së Suedisë.

LISTA E SHKURTESAVE

PBB – Prodhimi Bruto i Brendshëm

KEDNJ – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

GJED – Gjykata Evropiane e Drejtësisë

GJEDNJ – Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

BE – Bashkimi Evropian

LVK – Ligji për Veprim Klimatik

GNK – Gazi natyror i kompresuar

MPB – Ministria e Punëve të Brendshme

ME – Ministria e Ekonomisë

MMJPH – Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

MTL – Ministria e Transportit dhe Lidhjeve

PNEK – Plani Nacional i Energjisë dhe Klimës

PNIMD – Programi Nacional për Miratimin e të Drejtës së Bashkimit Evropian

SNT – Strategjia Nacionale e Transportit

VNMJAS – Vlerësimi ndaj ndikimit mjedisit jetësor dhe aspektet

RMV – Republika e Maqedonisë së Veriut

BUR1, BUR2, BUR3 – Raporti dyvjeçar i parë, i dytë dhe i tretë
(ang. First, Second, Third Biennial Update Report)

EBOR – Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
(ang. European Bank for Reconstruction and Development)

EEA – Agjencia Evropiane e Mjedisit Jetësor (ang. European Environmental Agency)

EIB – Banka Evropiane e Investimeve (ang. European Investment Bank)

GEF – Fondi Global i Mjedisit jetësor (ang. Global Environmental Facility)

GCF – Fondi i Gjelbër i Klimës (ang. Green Climate Fund)

IPCC – Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike
(ang. Intergovernmental Panel on Climate Change)

NC1, NC2, NC3, NC4 – Plani i parë, i dytë, i tretë, i katërt nacional për ndryshimet klimatike
(ang. First, Second, Third, Fourth National Communication)

TEN-T – Rrjeti trans-evropian i transportit (ang. Trans-European Transport Network)

UNFCCC – Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
(ang. United Nations Framework Convention on Climate Change)

UNDP – Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
(ang. United Nations Development Programme)

WEM – Skenari me politika dhe masa ekzistuese (ang. With Existing Measures)

WAM – Skenar me politika dhe masa shtesë (ang. With Additional Measures)

PËRMIBAJTJA

| | |
|---|-----------|
| 1. HYRJE | 1 |
| 1.2. Struktura e analizës | 1 |
| 1.3. Objektivat e analizës | 2 |
| 1.3. Metodologjia e aplikuar në analizë | 2 |
| 2. KORNIZA LIGJORE VENDORE PËRKATËSE | 4 |
| 2.1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut | 4 |
| 2.2. Ligjet dhe aktet nënligjore | 4 |
| 2.3. Detyrimi për të paguar taksën për emetimin e karbonit | 11 |
| 3. MEKANIZMAT NDËRKOMBËTARË PËR MBROJTJEN E MJEDISIT JETËSOR | 13 |
| 3.1. Roli i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në segmentin e zbutjes së ndryshimeve klimatike | 13 |
| 3.1.1. Rastet e para të GJEDNJ-së me fokus ndryshimet klimatike | 13 |
| 3.2. Roli i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në segmentin e zbutjes së ndryshimeve klimatike | 15 |
| 3.2.1. Praktika gjyqësore e GJED-së me fokus në ndryshimet klimatike | 15 |
| 3.3. Roli, qasja dhe dallimet ndërmjet GJEDNJ-së dhe GJED-së në mbrojtjen e mjedisit jetësor | 17 |
| 4. STRUKTURA DHE ORGANIZIMI INSTITUCIONAL | 19 |
| 4.1. Korniza institucionale në sektorin e transportit | 19 |
| 4.2. Struktura institucionale për ndryshimet klimatike në nivel nacional | 20 |
| 5. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I PARAMETRAVE BAZË PËR GJENDJEN NË TRANSPORT | 23 |
| 5.1. Numri i përgjithshëm i automjeteve sipas kategorive | 23 |
| 5.2. Automjetet motorike të udhëtarëve sipas llojit të karburantit | 24 |
| 5.3. Automjetet motorike të udhëtarëve sipas vjetërsisë | 25 |
| 6. TRANSPORTI NË INVENTARIN NACIONAL TË EMETIMEVE TË GAZRAVE SERRË | 27 |
| 6.1. Kontributi i transportit në emetimet e gazrave serrë | 27 |
| 6.1.1. Trendi i emetimeve të gazrave serrë – Sektori i energjisë | 27 |
| 6.1.2. Trendi i emetimeve të gazrave serrë – Kategoria e transport | 28 |
| 6.2. Projektionet e emetimeve të gazrave serrë nga transporti | 29 |
| 6.2.1. Sistemi energjetik në tranzicion | 29 |
| 6.2.2. Konsumi i energjisë dhe zhvillimi i emetimeve gazrave serrë nga transporti | 30 |
| 6.3. Procedurat e raportimit | 32 |
| 7. PLANIFIKIMI I QËNDRUESHMËRISË NË TRANSPORT DHE NDIKIMI NË NDRYSHIMET KLIMATIKE – OBJEKTIVAT DHE REKOMANDIMET NË STRATEGJITË KOMBËTARE | 34 |
| 7.1. Strategjia Nationale e Transportit 2018–2030 | 34 |
| 7.1.1. Objektivi kryesor | 34 |
| 7.1.2. Objektivat e përgjithshme dhe specifike | 34 |
| 7.1.3. Masat e propozuara për menaxhimin dhe shërbimet e sektorit të transportit dhe masat e propozuara infrastrukturore | 35 |
| 7.2. Strategjia Nationale për Zhvillim të Qëndrueshëm 2009–2030 | 38 |
| 7.2.1. Konkluzionet e Grupit të Punës: Politika dhe Korniza Ligjore | 38 |
| 7.2.2. Konkluzionet e grupit të punës: Mjedisi jetësor – nevoja për kapacitet administrativ dhe kapacitet për zbatimin e ligjeve | 39 |
| 7.2.3. Konkluzionet e grupit të punës: Energjia – nevoja për ndryshime strukturore në lidhje meburimet e energjisë dhe çmimet e energjisë | 40 |
| 7.2.4. Përmbledhje e konkluzioneve të grupeve të punës të specifikuar | 41 |

| | |
|--|-----------|
| 8. ANALIZA E KORNIZËS LEGJISLATIVE DHE STRATEGJIKE PËR INFRASTRUKTURËN E TRANSPORTIT REZISTENTE NDAJ KLIMËS | 41 |
| 8.1. Pasqyrë e shkurtër e infrastrukturës në sektorin e transportit | 41 |
| 8.2. Praktikrat që lidhen me mbrojtjen e klimës të infrastrukturës së transportit | 42 |
| 8.3. Gjetjet kryesore dhe rekomandimet për sektorin e transportit | 45 |
| 8.3.1. Gjetjet kryesore | 45 |
| 8.3.2. Rekomandimet | 45 |
| 9. TRANSPORTI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE NË STRATEGJINË AFATGJATE PËR VEPRIMIN KLIMATIK ME PLAN VEPRIM | 47 |
| 9.1. Objektivat specifike që lidhen me sektorin e transportit | 47 |
| 9.2. Aktivitetet e propozuara në transport për zbatimin objektivit të zbutjes | 49 |
| 9.3. Koordinimi horizontal për zbatimin e objektivave | 54 |
| 9.4. Aktivitete për forcimin e kapaciteteve institucionale | 55 |
| 10. SEMAFORI I PAJTUESHMËRISË | 59 |
| ANEKSI 1: Analiza PESTLE | 64 |
| LITERATURA | 68 |

PËRIMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Reduktimi i emetimeve të gazrave serrë ka qenë një nga sfidat kryesore globale për një kohë të gjatë. Rrjedhimisht, në nivel global po krijohet vazhdimisht një kornizë kohore me përqindje të përcaktuara qartë, sipas të cilave duhet të reduktohen gazrat serrë. Reduktimi i gazeve serrë presupozon një reduktim të emetimeve të karbonit nga burimet, duke përfshirë transportin.

Sipas analizave dhe projeksioneve, në RMV transporti zë 28% dhe është në vendin e dytë në burimin më të madh nacional të emetimeve të gazrave serrë, gjegjësisht sektori i energjisë. Parashikimet për vitin 2050 tregojnë se emetimet e gazrave serrë nga transporti do të ulen me një përqindje të vogël, pra do të arrijnë në 22%. Prandaj, ulja e ndikimit të transportit në ndryshimet klimatike është në krye të agjendës së BE-së, si dhe në agjendën tonë nacionale.

Struktura konceptuale e analizës në këtë dokument është në funksion të përmbushjes së dy objektivave bazë:

1. Roli i udhërrëfyesit në legjislacionin nacional për sektorin civil dhe në drejtim të përmirësimit të kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile për përfaqësimin dhe monitorimin e proceseve ligjore që lidhen me këtë fushë.

2. Rritja e ndërgjegjësimit të organizatave të shoqërisë civile dhe publikut të gjerë për mundësitë e zhvillimit të sektorëve të gjelbër me nivele të ulëta të emetimeve, por edhe rritjen e presionit publik mbi institucionet me synimin e zhvillimit të politikave, programeve dhe zbatimit të masave që synojnë reduktimin e emetimeve të gazeve serrë dhe dekarbonizimit.

Realizimi i qëllimit të parë u arrit duke analizuar kornizën ligjore vendore dhe ndërkombëtar në fushën e transportit dhe ndikimin e ndryshimeve klimatike.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përkundër faktit se është anëtare e të gjitha organizatave ndërkombëtare, ende nuk ekziston një qasje e integruar në fushën e transportit përmes së cilës do të zbatohet një politikë e reduktimit të sasisë së karbonit të prodhuar nga automjetet e transportit por ka vetëm një rregullim të pjesshëm të këtij segmenti. Për sa i përket kornizës ligjore, Maqedonia e Veriut ka një qasje të fragmentuar, sepse në të drejtën pozitive nuk ekziston një akt ligjor mbështetës mbi bazën e të cilit do të zbatohen qëllimet strategjike të përcaktuara qartë të Strategjisë Nacionale të Transportit 2018-2030. Qasja e fragmentuar është evidente nga fakti se vetëm disa ligje rregullojnë çështjen e parandalimit të emetimeve të karbonit nga automjetet në lloje të ndryshme të trafikut. Para së gjithash, rregullohet vetëm qarkullimi me avull, por jo edhe për llojet e tjera të komunikacionit, ujor, ajror dhe hekurudhor. Megjithatë, përcaktimi strategjik i Maqedonisë së Veriut është mishëruar në Projektligjin për Veprimin Klimatik, i cili tenton të ketë një qasje gjithëpërfshirëse për gjetjen e zgjidhjeve për sfidat që dalin nga ndryshimet klimatike.

Ngjashëm me kornizën ligjore, kompetencat e autoriteteve publike janë të kufizuara, edhe kur bëhet fjalë për Ministrinë e Mjedisit Jetësor, ku ndryshimet klimatike organizohen në nivel departamenti, jo në nivel sektori, që do të ishte një nivel dhe prioritet më i përshtatshëm.

Që ndryshimet klimatike janë një risi për rendin ndërkombëtar vihet re nga fakti se para gjykatave evropiane, Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Gjykatës Evropiane të Drejtësisë janë vetëm disa çështje që janë në proces zgjidhjeje, ndërsa vetëm në rastin T-330/18 Armando Ferrão Carvalho and Others kundër Parlamentit Evropian dhe Këshillit, gjykatat konstatuan se paditësit nuk prekeshin individualisht nga politika klimatike e Bashkimit Evropian.

Qëllimi i dytë u arrit fillimisht përmes analizës së synimeve dhe rekomandimeve në strategjitë nacionale lidhur me transportin, në drejtim të planifikimit të qëndrueshëm të transportit dhe reduktimit të emetimeve të gazrave serrë. Nëse merret parasysh se transporti është njëkohësisht burim i emetimeve të gazrave serrë dhe një sektor që vuan ndikime negative nga ndryshimet klimatike, dokumenti gjithashtu jep rekomandime për përmirësimin e rezistencës klimatike të infrastrukturës së transportit. Në fund, analiza finalizohet me prezantimin e masave dhe aktiviteteve në transport, si dhe aktivitetet për bashkëpunim ndërsektorial, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe nevojën për mbikëqyrje në zbatimin e tyre. Organizatat civile, si dhe publiku i gjerë, kanë mundësinë të monitorojnë dhe të reagojnë ndaj zbatimit të masave dhe aktiviteteve të përcaktuara në strategjitë kombëtare në lidhje me periudhat kohore të parashikuara dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e tyre. Në këtë mënyrë, organizatat e shoqërisë civile dhe publiku do të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshmërisë në transport dhe në uljen e ndikimit negativ të tij në ndryshimet klimatike.

1. HYRJJE

Kjo analizë është realizuar në kuadër të projektit *“Organizatrat civile në veprim për ndryshimet klimatike”*, mbështetur nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim– SIDA, dhe i implementuar nga Qendra për Hulumtim dhe Informim për Mjedisin Jetësor “Eko-svest” nga Shkupi, Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë (SHJRM) dhe Organizata Lidhja e Vlerave Natyrore dhe Njerëzve-CNVP.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është forcimi i rolit të shoqërisë civile në procesin e dekarbonizimit, transformimit dhe rindërtimit të shoqërisë, krijimi i mjedisit jetësor të pastër, inkurajimi i ekonomisë së gjelbër dhe përmirësimi i shëndetit të qytetarëve në vend.

Nëpërmjet analizës është realizuar mbledhja e të dhënave, hartografimi, vlerësimi ligjor i legjislacionit dhe rregullores nacionale dhe ndërkombëtare për të siguruar sistemim të qartë të rregullores përkatëse dhe për të identifikuar detyrimet e institucioneve shtetërore në lidhje me sektorin e transportit.

1.1. Struktura e analizës

Analiza përbëhet nga dhjetë kapituj dhe një aneks. Kapitujt mund të grupohen në tre pjesë integrale.

Pjesa e parë integrale (Kapitujt 2 dhe 3) mbulojnë kornizën përkatëse ligjore vendore, institucionet kompetente dhe mekanizmat ndërkombëtarë për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Përkatësisht, në kapitullin 2 është bërë një pasqyrë e akteve juridike, duke filluar nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut si akti më i lartë juridik dhe ligjet, duke përfshirë aktet nënligjore që rregullojnë çështjet e transportit dhe emetimin e gazeve serrë. Në Kapitullin 2, krahas kornizës ligjore përkatëse, bëhet një rishikim i institucioneve kompetente shtetërore në segmentin e transportit dhe ndryshimeve klimatike, me rishikim të kompetencave të tyre. Kapitulli 3 mbulon mekanizmat ndërkombëtarë për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe rolin e tyre në segmentin e zbutjes së ndryshimeve klimatike. Në këtë seksion, fokusi është në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut dhe në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë përmes rasteve që ato drejtojnë për ndryshimet klimatike.

Pjesa e dytë integrale e analizës mbulon Kapitujt 4, 5 dhe 6 dhe fokusohet në disa tema: vendosja institucionale dhe funksionimi i sektorit të transportit dhe struktura nacionale e ndryshimeve klimatike; gjendja në transport si burim i emetimeve të gazrave serrë dhe kontributi i transportit në inventarin nacional të emetimeve të gazrave serrë. Në këtë pjesë të dytë, fillimisht prezantohen institucionet kryesore, detyrat, kompetencat e tyre dhe ndërlidhja në funksionim. Më pas, jepet një pasqyrë e parametrave bazë në transport (numri total i automjeteve, kategorizimi i automjeteve sipas karburantit dhe vjetërsisë etj.), si arsye për shfaqjen e emetimeve të gazrave serrë nga ky sektor. Është analizuar kontributi i transportit në emetimet totale të gazrave serrë për periudhën 1990-2019 dhe më pas janë paraqitur projeksionet për kontributin e sektorit të transportit deri në vitin 2050.

Pjesa e tretë integrale (Kapitujt 7, 8, 9 dhe 10) jep udhëzime të detajuara për zhvillimin e qëndrueshëm dhe marrjen e masave në transport, si dhe aktivitete për bashkëpunim ndërsektorial, forcimin të kapaciteteve institucionale dhe nevojës për mbikëqyrje në zbatimin e tyre. Kjo u realizua sipas synimeve dhe rekomandimeve në strategjitë nacionale dhe në drejtim të planifikimit të qëndrueshëm të transportit dhe reduktimit të ndikimit në emetimet e gazrave serrë. Duke qenë se ndryshimet klimatike kanë edhe efekt kthyes në gjendjen në transport, u bë një analizë me rekomandime për përmirësimin e rezistencës klimatike të infrastrukturës së transportit.

Në fund të kësaj pjese, “Semafori për pajtueshmëri” paraqitet si një instrument që tregon vizualisht situatën në sektorin e transportit nga këndvështrimi: i përputhshmërisë strategjike, kapaciteteve organizative dhe kryerjes së detyrave për të arritur rezultate në këtë sektor. Krijimi i këtij semafori është rezultat i integritimit të njohurive të marra gjatë hulumtimit dhe intervistave.

Në fund, Aneksi 1 i këtij dokumenti tregon analizën PESTLE, e cila identifikon dhe analizon nxitësit kritikë të ndryshimit jashtë sektorit dhe paraqet një vlerësim për të marrë në konsideratë qëllimin, karakteristikat ose planet në drejtim të përmirësimit të kushteve në sektorin e transportit.

1.2. Objektivat e analizës

Analiza ka dy objektiva:

1. Analiza e gjendjes dhe zhvillimi i transportit si burim i emetimeve të gazrave serrë duhet të jetë një udhërrëfyes në legjislacionin nacional për sektorin civil, i cili do të përmirësojë kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile për përfaqësim dhe monitorim të proceseve ligjore që lidhen me këtë fushë. Ky objektivi është i lidhur ngushtë me një nga qëllimet e veçanta të projektit për të inkurajuar pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në marrjen e vendimeve lidhur me ndryshimet klimatike, si dhe duke përmirësuar kapacitetet, njohuritë dhe aftësitë, duke ofruar mbështetje për organizatat e shoqërisë civile për ndërmarrjen e aktiviteteve në nivel lokal.

2. Objektivi i dytë i analizës është rritja e ndërgjegjësimit të organizatave të shoqërisë civile dhe publikut të gjerë për mundësitë e zhvillimit të sektorëve të gjelbër me nivel të ulët të emetimeve, por edhe të rrisë presionin e publikut ndaj institucioneve për të zhvilluar politikat, programet dhe zbatimin e masave në drejtim të reduktimit të emetimeve të gazeve serrë dhe dekarbonizimit.

1.3. Metodologjia e aplikuar në punë

Hulumtimi dhe përgatitja e këtij dokumenti u realizua në periudhën shkurt-prill 2023, me punën ekipore teknike dhe të ekspertit ligjor.

Të dhënat e paraqitura dokumentohen duke përdorur metodat e analizës dhe sintezës me një përshkrim të detajuar dhe paraqitje grafike të rezultateve të hulumtimit. Analiza e situatës në transport është kryer me metodën e klasifikimit të parametrave dhe me metodën statistikore të përpunimit të të dhënave, mbështetur nga një paraqitje grafike e rezultateve.

Gjatë krahasimit të qëllimeve dhe rekomandimeve nga strategjitë nacionale dhe situatës aktuale me zbatimin e tyre praktik, është përdorur metoda krahasuese. Masat dhe aktivitetet e përcaktuara në sektorin e transportit, si dhe aktivitetet për koordinimin horizontal dhe ngritjen e kapaciteteve, janë përcaktuar në mënyrë të detajuar duke aplikuar metodën përshkruese. Njohuritë e caktuara për zbatimin e masave dhe aktiviteteve janë marrë me metodën e intervistës.

Duke pasur parasysh se përveç të dhënave në dispozicion, nevojiteshin edhe njohuri për praktikën në zbatimin e dokumenteve strategjike dhe akteve ligjore, janë realizuar edhe intervista me zyrtarë nga institucionet kompetente.

Të dhënat dhe gjetjet e paraqitura në analizë janë marrë nëpërmjet burimeve në vazhdim:

I. Dokumentet përkatëse vendore dhe ndërkombëtare

Gjatë përgatitjes së kësaj analize janë shfrytëzuar një numër i madh dokumentesh, ku përfshihen: Kushtetuta e RMV-së, aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, si dhe projektligjet në fushën e transportit dhe ndryshimeve klimatike, strategjitë nacionale, planet, raportet vjetore, raportet e projekteve, studime, si dhe burime ndërkombëtare me fokus të veçantë në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut dhe Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

II. Intervistë me përfaqësues të sektorit të transportit

Intervistat ballë për ballë kanë disa qëllime:

- Merret pasqyrë e drejtpërdrejtë të situatës në transport përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me përfaqësues dhe të punësuar në këtë sektor;
- Paraqesin një mjet për sintetizimin e të dhënave dhe plotësimin e boshllëqeve që shfaqen përmes metodave të tjera.

Për përgatitjen e kësaj analize janë intervistuar katër persona, të përfshirë në mënyrë aktive në fusha të ndryshme që lidhen me sektorin e transportit: një magjistër në shkencat e trafikut, një punonjës i Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve dhe dy doktorë shkencash, profesorë të Departamentit të Komunikacionit dhe Transportit në Fakultetin Teknik në Manastir, në drejtimet e planifikimit të komunikacionit dhe transportit integral. Disa aspekte të nevojshme për të përfunduar analizën janë marrë nga bisedat me inxhinierë komunikacioni të punësuar në kompanitë e transportit publik dhe në kompanitë private të projektimit të komunikacionit.

Në fund të hulumtimit, gjatë përcaktimit të semaforit të përputhshmërisë dhe analizës PESTLE, është aplikuar metoda e deduksionit, për të nxjerrë konkluzione dhe pretendime specifike individuale nga njohuritë e përgjithshme për sektorin e transportit, veçanërisht për pajtueshmërinë strategjike, realizimin e detyrave dhe përmbushjen e detyrimeve për zhvillim të qëndrueshëm dhe drejtimet për përmirësimin e sektorit të transportit.

2. KORNIZA LIGJORE VENDORË PËRKATËSE

Transporti dhe komunikacioni në të drejtën pozitive në Maqedoninë e Veriut paraqesin segment të veçantë si në fushën e legjislacionit ashtu edhe në fushën e kompetencave. Në kuadër të këtij segmenti, legjislacioni e rregullon plotësisht trafikun dhe transportin në territorin e Maqedonisë së Veriut sipas llojit të komunikacionit dhe transportit, i cili mund të jetë tokësor, ajror dhe ujor. Nga ana tjetër, çështja e gazrave serrë rregullohet me një numër më të vogël aktesh ligjore dhe janë pjesë e rregullores që ka të bëjë me mjedisin. Prandaj, kjo çështje është e rregulluar në shtrirje më të gjerë, para së gjithash, me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

2.1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut [1] në pjesën për vlerat themelore kushtetuese në nenin 8, alineja paragrafi 10 parasheh se *“vlerat themelore të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë janë - rregullimi dhe humanizimi i hapësirës dhe mbrojtja dhe përparimi i mjedisit jetësor dhe i natyrës,”* duke vënë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit në themel të rregullimit kushtetues, sipas të cilit ndërtohet shoqëria.

Garancia për promovimin dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor është e rregulluar me Kushtetutë në nenin 43, ku parasheh të drejtën individuale, por edhe obligimin e çdo personi për mjedis jetësor të shëndetshëm pa e kufizuar atë në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Përveç përcaktimit të së drejtës dhe detyrimit individual, Kushtetuta forcon të drejtën për një mjedis jetësor të shëndetshëm me detyrimin e shtetit për të ofruar kushte për realizimin e kësaj të drejte specifike të njeriut.

Kushtetuta e RMV-së, përveç vlerës themelore dhe të drejtës për mjedis jetësor të shëndetshëm, edhe në nenin 55 vendos kufizime të jashtëzakonshme për lirinë e tregut dhe sipërmarrjes, ndër të tjera, në bazë të ruajtjes së natyrës dhe mjedisit jetësor.

Siç shihet nga korniza kushtetuese në këtë mënyrë, mund të konstatohet se Kushtetuta e RMV-së ofron garanci të gjera në fushën e mbrojtjes dhe përmirësimit të mjedisit jetësor si në nivel të përgjithshëm ashtu edhe në atë individual. Megjithatë, vetë Kushtetuta, e cila u miratua në vitin 1991, nuk parashikon dispozita të veçanta që rregullojnë çështjen e ndryshimeve klimatike dhe brenda saj, eventualisht edhe për gazrat serrë.

Transporti, komunikacioni, nga njëra anë dhe çështja e gazeve serrë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nga ana tjetër, paraqesin segmente të ndërlidhura. Rregullimi ligjor i transportit dhe komunikacionit rregullohet me akte të veçanta ligjore që rregullojnë të tri llojet e komunikacionit, përkatësisht transportin - tokësor, ajror dhe ujor.

2.2. Ligjet dhe aktet nënligjore

Përkatësisht, komunikacioni tokësor rregullohet kryesisht përmes **LIGJI PËR TRANSPORTIN NË KOMUNIKACIONIN RRUGOR** [2]. Ky ligj i **rregullon** kushtet dhe mënyrën e realizimit të transportit të udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin rrugor të brendshëm dhe ndërkombëtar. Gjegjësisht, ky ligj rregullon si transportin e udhëtarëve ashtu edhe transportin e mallrave, si dhe transportin për nevoja

personale, i cili kryhet përmes dhënies së licencave të transportit. Mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë të tij kryhen Ministria e Transportit dhe Lidhjeve. Mbikëqyrja inspektuese mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të rregulloreve të miratuara në bazë të ligjit që kanë të bëjnë me transportin ndërkomunal të udhëtarëve me linjë të veçantë ndërmjet dy ose më shumë komunave dhe transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe transportin e mallrave në komunikacionin rrugor të brendshëm dhe ndërkombëtar kryhet nga Inspektorati Shtetëror i Transportit, nëpërmjet inspektorëve shtetërorë të komunikacionit rrugor.

Ligji për automjetet [3] i rregullon kushtet për nxjerrjen në treg të automjeteve dhe fillimin e përdorimit, regjistrimin dhe korrektësinë teknike të automjeteve, kushtet për kryerjen e punimeve nga shërbimet teknike, personat juridikë për kontroll teknik dhe personat juridikë për regjistrim dhe regjistrin e të dhënave të automjetit. Ndryshe nga Ligji për komunikacionin rrugor, ky ligj, para së gjithash, rregullon çështjen e korrektësisë teknike të automjeteve për komunikacionin rrugor dhe rrjedhimisht edhe kontrollin e shkarkimit të gazrave serrë që emetojnë automjetet. Ky ligj parashikon **kategorinë e veçantë ekologjike të automjeteve në përputhje** nivelin e emetimit të gazrave të shkarkimit nga motorët e automjeteve, si dhe **Ngjitësja ekologjike me të cilin është shënuar** kategoria ekologjike e automjetit. Kategorizimi ekologjik i automjeteve kryhet në tre kategori ekologjike - kategoria e parë ekologjike me një nivel të emetimit të gazrave të shkarkimit EURO 5 dhe më të lartë, kategoria e dytë ekologjike përfshin automjetet me një nivel të emetimit të gazrave të shkarkimit EURO 4 dhe EURO 3 dhe Kategoria e tretë (më e ulët) ekologjike përfshin automjetet me një nivel emetimi të gazrave të shkarkimit EURO 2 dhe më të ulët, si dhe automjetet për të cilat prodhuesi nuk ka përcaktuar një emetim të gazrave të shkarkimit.

Ngjitëset ekologjike ndahen nga shërbimet teknike të autorizuara nga Ministria e Ekonomisë për të kryer kategorizimin ekologjik të automjeteve. Puna e shërbimeve teknike kryhet nga persona juridikë të autorizuar me vendim të Ministrisë së Ekonomisë, pas propozimit për autorizim për shërbim teknik nga autoriteti miratues dhe në bazë të një certifikate akreditimi të lëshuar nga autoriteti për vlerësim të kompetencës.

Ligji parashikon gjithashtu një detyrim të veçantë për përcaktimin, dorëzimin e procedurës për regjistrimin e automjetit dhe regjistrin të vlerave të matura nga shkarkimet e gazrave të automjetit.

Institucionet kompetente që monitorojnë zbatimin e këtij ligji janë Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Ekonomisë në fushën e kompetencave të tyre. Përkatësisht, Ministria e Ekonomisë është kompetente në fushën e dhënies së autorizimit për kryerjen e identifikimit dhe vlerësimit të gjendjes teknike, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme është kompetente për mbikëqyrjen e korrektësisë teknike të automjeteve në komunikacionin rrugor, e cila ndër të tjera i referohet edhe emetimit të gazrave të shkarkimit.

Rregulloren për informacionin në dispozicion të konsumatorit për konsumin e karburantit dhe emetimet e CO₂ në lidhje me shitjen e automjeteve të reja të udhëtimit [4], i cili përshkruan informacione për konsumin e karburantit dhe emetimet e CO₂ të automjeteve të reja të udhëtimit që shiten në treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Vetë rregullorja parashikon emetimet zyrtare specifike të CO₂ dhe një etiketë të konsumit të karburantit, si dhe një doracak informacioni mbi konsumin e karburantit dhe emetimet e CO₂ të automjetit specifik të udhëtimit. Në këtë doracak, ndër të tjera, shpjegohen efektet e emetimeve të gazeve serrë, ndryshimet e mundshme klimatike, si referencë për konsumatorët mbi mundësinë e zgjedhjes së përdorimit të llojeve të tjera të lëndëve djegëse motorike, me një përshkrim të ndikimit të tyre në mjedis jetësor bazuar në njohuritë dhe kërkesat më të fundit shkencore sipas rregulloreve të emetimit të CO₂.

LIGJI PËR SIGURINË NË KOMUNIKACIONIN RRUGOR [5] rregullon segmentin e sigurisë së rrugëve përgjatë të cilave zhvillohet komunikacioni tokësor, përkatësisht rrugor. Përkatësisht, ky ligj parasheh rregullimin dhe vendosjen e kushteve për sigurinë dhe mbrojtjen e rrugëve dhe marrëdhëniet e ndërsjella të pjesëmarrësve dhe subjekteve të tjera në komunikacionin rrugor, si dhe rregullat e komunikacionit rrugor, sistemit të komunikacionit shenjat, pajisjet dhe sinjalistika e rrugëve, obligimet në rast aksidenti trafiku dhe masat e veçanta të sigurisë, organizimi dhe detyrat e këshillave të sigurisë në komunikacionin rrugor dhe segmenteve të tjera me rëndësi për sigurinë në komunikacion. Në pjesën e segmentit të shkarkimeve nga mjetet motorike, ky ligj parasheh kompetencë të veçantë të vetëqeverisjes lokale, përkatësisht komunave që të krijojnë zona të veçanta në të cilat do të ketë emetim të ulët të gazrave të dëmshëm nga automjetet që marrin pjesë në komunikacionin rrugor. Neni 7 i ligjit përcakton se "Komunat dhe qyteti i Shkupit rregullojnë komunikacionin në rrugët lokale në zonën e tyre, në pajtim me dispozitat e këtij ligji". Nga këtu, Ligji, përveç elementeve të tjera të rregullimit të komunikacionit në rrugët lokale, parasheh kompetencën e vetëqeverisjes lokale në pjesën e përcaktimit të zonave me emetim të ulët të gazrave të dëmshëm nga automjetet dhe kushtet për qarkullimin e automjeteve në to, për të cilin vetëqeverisja lokale e lëshon miratimin.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut e miratoi në janar 2019, pas propozimit të ministrit të Transportit dhe Lidhjeve – **STRATEGJINË NACIONALE TË TRANSPORTIT 2018-2030** [6]. Kjo Strategji afatgjate bazohet, mbi të gjitha, në katër objektiva të përgjithshme, ndër të cilat është qëllimi i përgjithshëm "Futja e lëvizshmërisë së gjelbër dhe logjistikës me fokus në efektivitetin ekologjik të sektorit të transportit", i cili pritet të rezultojë në "reduktimin e emetimeve të gazrave serrë" nga transporti me 15.1% në vitin 2025 dhe me 18.6 % në vitin 2030 krahasuar me nivelet në vitet përkatëse në skenarin "Mos bëj asgjë." Në kuadër të këtij objektivi të përgjithshëm, Strategjia parashikon tre objektiva të veçanta: 1) Zhvillimin dhe promovimin e sistemeve të transportit ekologjikisht të pranueshme me nivel të ulët të karbonit; 2) Të stimulohet ndryshimi nga një lloj transporti në tjetrin dhe 3) Të rritet rëndësia e transportit intermodal dhe multimodal në politikën nacionale të transportit. Në pjesën e masës së parë të posaçme, parashikohet një devijim drejt mënyrave të transportit me karbon të ulët dhe përmirësimi i efikasitetit të automjeteve, i cili duhet të rezultojë në uljen e trafikut dhe kostove që lidhen me të, përmes të cilit duhet të kontribuohet më shumë në reduktimin dhe përmirësimin e shëndetit publik dhe ndotja nga automjetet. Masa e dytë e veçantë parashikon inkurajimin e përdorimit të trafikut hekurudhor kundrejt trafikut rrugor, kryesisht për faktin se emetimet e CO₂ nga transporti hekurudhor janë dhjetë herë më të ulëta në krahasim me transportin rrugor, sipas shifrave të Agjencisë Evropiane të Mjedisit Jetësor. Në kuadër të masës së tretë të veçantë, Strategjia parashikon që përmes saj Qeveria të inkurajojë sistemet intermodale që lehtësojnë dhe optimizojnë transferimin ndërmjet mënyrave të ndryshme të transportit.

LIGJI PËR SISTEMIN HEKURUDHOR [7] është ligj që rregullon në mënyrë të gjithanshme trafikun hekurudhor dhe infrastrukturën hekurudhore, organizimin e sistemit hekurudhor, mënyrën dhe kushtet e kryerjes së transportit hekurudhor dhe llojet e transportit, menaxhimin, organizimin, mbrojtjen e infrastrukturës hekurudhore dhe qasjen në infrastrukturën hekurudhore, tarifat e qasjes për shfrytëzimin e infrastrukturës hekurudhore, ndarja e objekteve të infrastrukturës, rrjeti, krijimi i një organi rregullator të pavarur dhe të vet-qëndrueshëm, ndarja dhe llojet e koncesioneve, financimi i infrastrukturës hekurudhore dhe shërbimeve me interes publik në transportin hekurudhor të udhëtarëve. Përkundër faktit se trafiku hekurudhor përfaqëson një pjesë të konsiderueshme të trafikut tokësor, ky ligj nuk rregullon çështjet që kanë të bëjnë me emetimet e gazrave serrë nga transporti hekurudhor duke ndjekur shembullin e Ligjit për Automjet.

Në pjesën e sistemit hekurudhor si pjesë e trafikut tokësor, i nënshtrohen çështjeve në lidhje me mbrojtjen e mjedisit jetësor në **Programi nacional për infrastrukturën hekurudhore për periudhën 2014-2016** [8], në të cilin është paraparë një pjesë e veçantë, 1.3. Mbrojtja e mjedisit jetësor. Në këtë pjesë, Programi parashikon parimet dhe masat bazë për realizimin e transportit ekologjikisht të qëndrueshëm, duke theksuar nivelin e arritur të zhvillimit ekonomik të vendit kundrejt kërkesës për transport në aspektin e ndikimit të mjedisit jetësor; plotësimi i kërkesës për transport mallrash dhe udhëtarësh duke përdorur mjete të ndryshme transporti, modele të ndryshme të mjeteve hekurudhore dhe infrastrukturës, si dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe investimet në transportin dhe infrastrukturën hekurudhore, të cilat do të nxisin zhvillimin e teknologjisë hekurudhore, industrisë, logjistikës dhe më shumë. Në të njëjtën kohë, Programi parashikon që nga analizat që i paraprinë vetë Programit, mjetet hekurudhore të vlerësohen si mjete transporti që kanë ndikimin më të favorshëm, pra ndotin më së paku mjedisin jetësor. Gjithashtu, analizat treguan se ky lloj transporti është një zëvendësim i favorshëm i transporteve voluminoze të mëdha të mallrave që kryhen në trafikun rrugor.

Pas përfundimit të **Programit nacional për infrastrukturën hekurudhore për periudhën 2014-2016, u miratua një program i ri nacional për infrastrukturën hekurudhore për periudhën 2019-2021** [9], në të cilin, ndryshe nga programi i mëparshëm, çështja e mjedisit jetësor nuk ishte fare elaboruar as sasia e gazeve serrë të gjeneruara nga transporti hekurudhor si pjesë e trafikut tokësor në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

LIGJI PËR AVIACIONIN [10] rregullon komunikacionin ajror në mënyrë që parasheh kushtet teknike për avionët dhe mjetet e tjera të komunikacionit ajror në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Por pavarësisht se ky ligj rregullon kushtet teknike në mënyrë të detajuar, vetë ligji nuk rregullon kushtet teknike në lidhje me gazrat e shkarkimit në kuadër të komunikacionit ajror, gjegjësisht aviacionit.

LIGJI I LUNDRIMIT NË BRENDËSI TË VENDIT [11] është i vetmi ligj që rregullon trafikun ujor në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Vetë ligji rregullon lundrimin në brendësi dhe sigurinë e lundrimit në ujërat e brendshme të territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut; kushtet dhe mënyra e përdorimit, mirëmbajtjes dhe mbrojtjes së rrugëve ujore, porteve, lagjeve dimërore, ankorimeve dhe pishinave; përkatësia shtetërore, identifikimi, regjistrimi dhe fshirja e objekteve lundruese; ekuipazhi i anijes; trajtimi në rast të një aksidenti detar; marrja e objekteve të fundosura; kompetenca e Kapitenerisë së Porteve; mbikëqyrjen dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me lundrimin në brendësi. Dispozitat e këtij ligji që i referohen anijeve zbatohen edhe për strukturat lundruese, varkat dhe anijet luftarake, vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ky ligj.

Në ndryshim nga ligjet e lartpërmendur, objekt i të cilave është rregullimi në fushën e komunikacionit dhe transportit dhe mjeteve të komunikacionit dhe transportit, **LIGJI PËR CILËSINË E AJRIT TË AMBIENTIT** [12] është një akt ligjor fokusi i të cilit është sigurimi i cilësisë së ajrit të ambientit nëpërmjet parandalimit, reduktimit, rehabilitimit dhe informimit në lidhje me kushtet me ajrin e ambientit. Konkretisht, ky ligj rregullon masat për shmangien, parandalimin ose zvogëlimin e efekteve të dëmshme të ndotjes së ajrit të ambientit në shëndetin e njeriut, si dhe mjedisin jetësor në tërësi, duke vendosur vlerat kufitare dhe të synuara për cilësinë e ajrit të ambientit dhe pragjet e alarmit dhe pragu i informacionit, vlerat kufitare dhe objektive për emetimet, krijimi i një sistemi të vetëm për monitorimin dhe kontrollin e cilësisë së ajrit të ambientit dhe monitorimin e burimeve të emetimeve, një sistem gjithëpërfshirës për menaxhimin e cilësisë së ajrit të ambientit dhe burimet e emetimeve, sistemin e informacionit, si dhe masa të tjera për të mbrojtur kundër veprimtarive të caktuara të personave juridikë dhe fizikë që kanë ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në cilësinë e ajrit të ambientit.

Vetë ligji, nga këndvështrimi i ndikimit të komunikacionit dhe transportit në ajrin e ambientit, jep një përkufizim për burimet e ndotjes së ajrit të ambientit nga mjetet me të cilat kryhet transporti, duke treguar burimet e lëvizshme të ndotjes, ku përfshihet djegia e brendshme e motorëve të instaluar në automjete dhe motorë me djegie të brendshme të inkuorporuar në mjetet lëvizëse jo-rrugore, lokomotiva, anije dhe avionë. Nga pikëpamja e vlerave kufitare të emetimeve të burimeve të lëvizshme të ndotjes, Ligji parashikon një normë referimi në lidhje me vlerat kufitare të emetimit të substancave ndotëse në gazrat nga mjetet e transportit si burime të lëvizshme të ndotjes. Gjegjësisht, Ligji i referohet rregulloreve që rregullojnë më saktë vlerat kufitare të automjeteve dhe në mënyrë plotësuese parasheh një detyrim të përgjithshëm që këto vlera kufitare të përcaktuara të jenë të detyrueshme për të gjitha burimet e lëvizshme të ndotjes. Kjo dispozitë në thelb është e pakuptueshme nga pikëpamja e faktit të lartpërmendur - se vetëm Ligji për Automjete i rregullon vlerat kufitare, vetëm në pjesën e automjeteve të udhëtareve, por jo edhe për avionët apo mjetet lundruese, për të cilat duhet të vendosen vlera të ndryshme kufitare të jepen vlera për shkak të specifikave të tyre.

Ligji, përveç përcaktimit të mjeteve të transportit, në pjesën për sanksionet parasheh edhe sanksione të veçanta në rast se në Republikën e Maqedonisë së Veriut prodhohen, importohen dhe vihen në qarkullim mjete transporti që nuk e plotësojnë vlerat kufitare të përcaktuara për emetimet nga burimet e lëvizshme në përputhje me rregulloret, vlerat kufitare të automjeteve rregullohen më saktë. Gjohat variojnë nga 18.000 deri në 200.000 euro, varësisht nga madhësia e personit juridik që do të konstatohet se ka kryer veprën penale.

I vetmi akt juridik që rregullon drejtpërdrejt çështjen e gazrave serrë në Republikën e Maqedonisë së Veriut është Ligji për Mjedisin Jetësor. Gjegjësisht, **LIGJI PËR MJEDISIN JETËSOR** [13] është një ligj sektorial, i cili rregullon kushtet dhe mënyrën e mbrojtjes dhe përmirësimit të mjedisit jetësor, për të ushtruar të drejtën e qytetarëve për një mjedis jetësor të shëndetshëm.

Në fushën e gazeve serrë, ligji parashikon miratimin e Planit Nacional për Ndryshimet Klimatike, i cili është në shërbim të stabilizimit të përqendrimeve të gazeve serrë në nivel që do të parandalonte ndikimin e rrezikshëm antropogjen në sistemin klimatik në një kornizë kohore e mjaftueshme për të lejuar që ekosistemet të përshtaten natyrshëm ndaj ndryshimeve klimatike, në përputhje me parimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe në përputhje me qëllimet e zhvillimit social dhe ekonomik nacional.

Plani Nacional për Ndryshimet Klimatike realizohet nga Qeveria e RMV-së me propozim të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor për një periudhë 6 vjeçare.

Deri më tani, në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë miratuar katër plane kombëtare për ndryshimet klimatike. Ligji parashikon që në përgatitjen e Draft Planit Nacional, duhet të marrin pjesë Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Menaxhimit të Ujërave, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve dhe Ministria e Shëndetësisë, si dhe Drejtoria për Çështje Hidrometeorologjike, të cilët e përgatisin atë në bazë të dokumenteve të miratuara të Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike.

Për zbatimin e planit nacional, ligji parashikon miratimin e një plan veprimi për ndryshimet klimatike, i cili është pjesë përbërëse e planit nacional. Plani i veprimit është në fakt një dokument që parashikon se si do të eliminohen shkaqet dhe do të zbuten efektet negative të ndryshimeve klimatike. Prandaj, plani i veprimit duhet të përmbajë domosdoshmërisht masa institucionale dhe ligjore, masa parandaluese dhe aktivitete për reduktimin e emetimeve të gazeve serrë, masa dhe aktivitete për zbutjen e efekteve negative të ndryshimeve klimatike, masa për edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut, masa për aftësimin profesional të stafit shkencor, teknik dhe menaxherial, si dhe një plan kohor dhe financiar për realizimin e masave dhe aktiviteteve të parapara. Nisur nga fakti se plani i veprimit është një dokument operacional, ligji parashikon që ai të përditësohet çdo tre vjet.

Në zbatimin e Planit Nacional marrin pjesë të njëjtat autoritete që kanë marrë pjesë në përgatitjen e tij duke vendosur bashkëpunim me të gjitha autoritetet kompetente gjatë zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara. Të gjitha autoritetet pjesëmarrëse në zbatimin e planit nacional janë të obliguara që së paku një herë në vit të informojnë Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor për nivelin e zbatimit, e cila më pas dorëzon raport çdo tre vjet në Qeverinë e RMV-së për nivelin e zbatimit të Planit Nacional.

Edhe sot këto përfundime nuk janë realizuar plotësisht, gjë që është vërtetuar edhe nga intervistat e realizuara. Prandaj, për tejkalimin e këtyre mangësive, në kapitullin 9 janë paraqitur aktivitetet 7, 8 dhe 9, me të dhëna të plota për periudhën e zbatimit, si dhe organet përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin.

7.2.2. Konkluzionet e grupit të punës: Mjedisi jetësor – nevoja për kapacitet administrativ dhe kapacitet për zbatimin e ligjeve

Për konkluzionet e këtij grupi, të cilat janë veçanërisht të rëndësishme edhe sot, mund të thuhet se zbatohen të njëjtat aktivitete (7, 8 dhe 9) të propozuara në kapitullin 9. Konkluzionet e konsoliduara në mjedisin jetësor reduktohen në sa vijon [36]:

- Mjedisi jetësor duhet të identifikohet si **prioritet ndërsektorial** nga Qeveria.
- Duhet të **forcohet kapaciteti** i Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor. Një analizë më e detajuar e kësaj është bërë në nënkapitullin 9.3, nga aspekti i vlerësimit të kapaciteteve administrative të MMJPH-së për trajtimin e ndryshimeve klimatike.
- **Përgatitja e indikatorëve për monitorimin e zhvillimit të qëndrueshëm** dhe krijimi i një sistemi gjithëpërfshirës të monitorimit dhe informacionit për mjedisin jetësor. Sot ky konkluzion është realizuar, d.m.th., konkretisht për sektorin e transportit, përcaktohen treguesit e qëndrueshmërisë dhe përfshihen rregullisht në raportet vjetore mjedisore me një qasje treguese.
- Rritja e ndjeshme e **zbatimit të ligjeve të miratuara**, mbështetja e autoriteteve qendrore dhe lokale për të zbatuar ligjet dhe për të rritur efikasitetin e administratës.
- **Të rritet ndërgjegjësimi i publikut për mjedisin jetësor** në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm dhe të nxjerrë në pah përfitimet ekonomike dhe sociale që sjell në jetën e përditshme sjellja e përgjegjshme ndaj mjedisit jetësor. Kjo, lidhet veçanërisht me objektivin specifik 9 të Strategjisë Afatgjatë të Veprimit Klimatik me Planin e Veprimit; ky objektivi përshkruhet në Kapitullin 9.
- **Të intensifikohet fokusi** në burimet alternative të energjisë, të cilat nuk janë të dëmshme për mjedisin jetësor dhe të shfrytëzohen mundësitë e veçanta të mjedisit jetësor në Republikën e Maqedonisë së Veriut në nxitjen e bashkëpunimit dhe menaxhimit në rajonin e gjerë. Përmbushja e kësaj konkluzioni është veçanërisht e rëndësishme për transportin, ku, pavarësisht se janë një nga burimet më të mëdha të kombit të emetimeve të serave, lëndët djegëse fosile kanë ende përdorimin më të madh.

7.2.3. Konkluzionet e grupit të punës: Energjia – nevoja për ndryshime strukturore në lidhje me burimet e energjisë dhe çmimet e energjisë

Konkluzionet e konsoliduara në sektorin e energjisë janë si në vijim [36]:

- Duhet të përgatitet një studim për shfrytëzimin e potencialit të burimeve të rinovueshme të energjisë. Sot, në RMV kemi të përgatitur tashmë një Strategji për zhvillimin e energjisë deri në vitin 2040 dhe një Plan Nacional për Energjinë dhe Klimën. Politika strategjike në Planin Nacional të Energjisë dhe Klimës [37] për dimensionin e **dekarbonizimit** parashikon realizimin e të gjitha aktiviteteve të identifikuar për të zbutur ndryshimet klimatike që do të reduktojnë më tej emetimet e gazrave serrë, duke rritur në të njëjtën kohë pjesën e burimeve të rinovueshme të energjisë në një mënyrë të qëndrueshme në konsumin bruto final të energjisë. Për sektorin e transportit parashikohet një rritje e konsumit të biokarburanteve, ku synimet për vitin 2030 janë 10% pjesë e energjisë së rinovueshme në konsumin final të energjisë në transport.

- Mekanizmi i zhvillimit të pastër sipas Protokollit të Kiotos duhet të përdoret si një mjet shtesë për zbatimin e projekteve për reduktimin e emetimeve të gazrave serrë.

7.2.4. Përmbledhje e konkluzioneve të grupeve të punës të specifikuar

Pra, edhe pse ka pasur progres pozitiv në disa aspekte në zhvillimin e qëndrueshëm të RMV-së që nga krijimi i strategjisë [36], ka ende disa konkluzione kryesore për të cilat duhet të punohet ende sot. Në vijim janë paraqitur ato konkluzione nga vlerësimi i atëhershëm gjithëpërfshirës për zhvillim të qëndrueshëm.

- Ndërgjegjësimi, mirëkuptimi dhe angazhimi i pamjaftueshëm i zhvilluar ndaj konceptit dhe parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm.

- Kuadri ligjor dhe rregullator i paplotë i zhvilluar për të mbështetur politikën e zhvillimit të qëndrueshëm.

- Nevoja për ridrejtim strategjik në segmente të caktuara në fushën e energjisë.

- **Nevoja për përmirësim të konsiderueshëm të rrjetit hekurudhor.** Në këtë dokument, në kapitullin 9.2, janë paraqitur aktivitetet 1 dhe 5, të cilat lidhen drejtpërdrejt me këtë konkluzion dhe janë të përcaktuara në Strategjinë Afatgjatë të Veprimit Klimatik me një plan veprimi [33]. Pra, këtij konkluzioni, i cili ka të bëjë drejtpërdrejt me transportin, tashmë i është kushtuar shumë vëmendje për zbatimin praktik.

- **Nevoja për fokus strategjik në fushën e planifikimit dhe ndërtimit të rrugëve.** Lidhur me këtë konkluzion, sot mund të theksohet se ndërtimi i infrastrukturës rrugore në nivel kombëtar është në drejtim të lidhjes me rrjetin TEN-T të BE-së dhe vëmendje i kushtohet edhe sigurimit të rezistencës klimatike të infrastrukturës (Kapitulli 8).

- Kapaciteti i dobët për operacione strategjike të bazuara në zhvillim të qëndrueshëm – planifikim, administrim dhe zbatim.

- Nevoja për zhvillim të gjithanshëm organizativ dhe forcimin institucional në të gjitha sferat e jetës publike (qasja ndërsektoriale dhe e integruar), duke përfshirë politikëbërjen, përgatitjen e kuadrit ligjor dhe rregullator, planifikimin strategjik, administrimin, monitorimin dhe zbatimin.

Pra, në Strategjinë Nationale për Zhvillimin e Qëndrueshëm, qysh në vitin 2009, janë vënë në dukje disa probleme në drejtim të zhvillimit dhe harmonizimit të kuadrit ligjor, zhvillimit të qasjes ndërsektoriale në zgjidhjen e problemeve dhe forcimit të kapaciteteve, të cilat janë aktuale edhe sot. Këto mangësi vihen në dukje edhe në Strategjinë Afatgjatë të Veprimit Klimatik me një plan veprimi [33] dhe në Planin Nacional të Energjisë dhe Klimës [37]. Prandaj, në kapitullin 9 të këtij dokumenti veçohen dhe paraqiten në mënyrë të detajuar aktivitetet që mund të kontribuojnë në tejkalimin e tyre.

8. ANALIZA E KORNIZËS LEGJISLATIVE DHE STRATEGJIKE PËR INFRASTRUKTURËN E TRANSPORTIT REZISTENTE NDAJ KLIMËS

8.1. Pasqyrë e shkurtër e infrastrukturës në sektorin e transportit

Rrugët

Sipas Strategjisë Nacionale të Transportit [34], infrastruktura ekzistuese e transportit në Maqedoninë e Veriut përbëhet nga 14.410 kilometra rrugë publike, 699 kilometra hekurudha dhe 2 aeroporte ndërkombëtare. Komunikacioni ajror organizohet përmes dy aeroporteve ndërkombëtare, në Shkup dhe Ohër. I vetmi transport ujor është në liqenin e Ohrit. Përveç disa linjave midis vendeve në Maqedoninë e Veriut, është krijuar një linjë liqenore ndërkombëtare midis Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, por ajo është sezonale.

Rrjeti rrugor përbëhet nga 899 kilometra autostrada shtetërore, 3778 kilometra rrugë rajonale dhe 9733 kilometra rrugë lokale. Shumica e këtyre rrugëve kanë dy korsi. Hekurudhat e hapura janë ndërtuar si hekurudha teke dhe vetëm një pjesë e Korridorit 10 janë të elektrizuara në rreth 34% të gjatësisë totale. Nuk ka lidhje hekurudhore me Shqipërinë dhe Bullgarinë. Është planifikuar ndërtimi i lidhjeve të reja hekurudhore në gjatësi prej 89 kilometrash nga Kumanova në kufirin bullgar dhe 66 kilometra nga Kërçova në kufirin shqiptar.

Infrastruktura rrugore përgjatë Korridorit 10 është e gjatë 195 kilometra dhe ndodhet në drejtimin nga Serbia në Greqi, dhe 83 për qind e kësaj rruge tashmë është ndërtuar sipas standardeve moderne të autostradës. Korridori 8 lidh Detin Adriatik me Detin e Zi dhe është i gjatë 298 kilometra. Vetëm 37% e infrastrukturës rrugore përgjatë Korridorit 8 është në nivel autostrade në përputhje me standardet. Korridori 10-d është pjesë e Korridorit 10, i cili fillon në Veles dhe përfundon në pikën kufitare me Greqinë. Gjatësia e kësaj rruge është 117 kilometra dhe ky seksion ka dy korsi. E gjithë gjatësia e Korridorit 10 ka përfunduar në gjysmën e parë të vitit 2018. Lidhja autostradë e Korridorit 8 nuk është realizuar dhe projektet janë në vazhdim.

Hekurudhat

Gjatësia e rrjetit hekurudhor në Maqedoninë e Veriut është pak më pak se 700 kilometra. Rindërtimi i pjesshëm i rreth 54 km të hekurudhës së Korridorit 10 është ende në vazhdim [34]. Megjithatë, linjat e mbetura hekurudhore duhet të rehabilitohen, si dhe të modernizohen sistemet e sinjalit dhe telekomunikacionit, si dhe të përmirësohen kushtet e stacioneve hekurudhore. Shumica e stacioneve hekurudhore janë ndërtuar sipas standardeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në Konventën Evropiane për Hekurudhat Ndërkombëtare për Transportin e Kombinuar.

Vlerësimet e Ndërmarrjes Publike Rrugorët Shtetërore është se pak më pak se 80 për qind e rrjetit rrugor kombëtar të RMV-së është në gjendje të mirë ose të kënaqshme. Megjithatë, të dhënat e Bankës Botërore tregojnë se vetëm 40% e autostradave janë në gjendje të mirë ose të kënaqshme [34]. Rreth 70% e lokomotivave dhe mjeteve motorike u prodhuan midis 1965 dhe 1974. Hekurudha e Korridorit 10 është me një binar, elektrizuar, kryesisht në gjendje mesatare, me dy seksione të rinovuara së fundmi Tabanovc-Kumanovë 11.6 km dhe Miravci-Smokvicë 12.5 km, që mund të cilësohen si gjendje të mirë. Hekurudha e Korridorit 8 ende nuk është ndërtuar plotësisht.

Aeroportet

Periudha e koncesionit për aeroportet filloi në vitin 2010, dhe punët e planifikuara sipas marrëveshjes koncesionare përfshinin ndërtimin e ndërtesës së re të terminalit të aeroportit në Shkup, zgjerimin e hapësirës, një ndërtesë të re administrative dhe një parking të ri në rrugën hyrëse. Aeroporti i Ohrit ka përfunduar modernizimin e ndërtesës së terminalit. Marrëveshja koncesionare parasheh edhe ndërtimin e një aeroporti të tretë për qarkullimin e mallrave afër Shtipit. Dy aeroportet kryesore në vend po modernizohen dhe rikonstruktohen.

8.2. Praktikrat që lidhen me mbrojtjen e klimës të infrastrukturës së transportit

Strategjia Nationale e Transportit 2018-2030 hedh një bazë të fortë për mbrojtjen e klimës së infrastrukturës. Ajo përmban aktivitete të planifikuara në mënyrë specifike [34]:

- Masa Rregullative (MR) 5, 1.3. amendimi i standardeve nacionale të infrastrukturës së transportit në lidhje me përfshirjen e qëndrueshmërisë së mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike.
- Veprimi strategjik OSM 19 3.1. Përgatitja e një studimi gjithëpërfshirës për të përcaktuar ndikimet e ndryshimeve klimatike, ndryshueshmërisë së klimës dhe kushteve ekstreme të motit në infrastrukturë dhe shërbime (rezistenca e rrjetit).

Këto aktivitete paraqesin një rrugë të qartë drejt mbrojtjes së klimës së infrastrukturës së transportit dhe mbetet ende për t'u përcaktuar se si do të arrihet kjo.

Korniza strategjike, së bashku me analizën e ligjeve nga legjislacioni primar, në lidhje me qëndrueshmërinë klimatike të infrastrukturës së transportit janë paraqitur në Tabelën 3.

Tabela 3: Analizë e kornizës ligjore dhe strategjike të sektorit të transportit [38]

| Zëri | Përshkrimi (përfshirë standardet si relevante) | Relevanca për detyrën | Niveli i përfshirjes së rezistencës klimatike – për sa i përket infrastrukturës | |
|---|---|---|---|---|
| | | | Niveli | Përshkrimi |
| Legjislacioni primar | | | Niveli | Përshkrimi |
| Ligji për Automjetet (2016) (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 140/08, 53/11, 123/12, 70/13, 164/13, 138/14, 154/15, 192/15, 39/16) | Qëllimi i këtij ligji është sigurimi i nivelit të lartë të sigurisë në komunikacionin rrugor, mbrojtja e jetës dhe shëndetit, mbrojtja e mjedisit jetësor dhe natyrës, si dhe efikasitetit energjetik | Një ligj që rregullon aspektet e transportit të qëndrueshëm dhe lëvizshmërisë potencialisht të zgjuar. | I ULËT | Nuk ka aspekte që lidhen me rezistencën klimatike të mbuluar nga ky ligj. |
| Ligji i Tatimit mbi Automjetet Motorike (2019) ("Gazeta Zyrtare RMV-së" Nr. 261/2019) | Qëllimi i këtij ligji është të rregullojë sistemin e tatimit të automjeteve në Maqedoninë e Veriut dhe kompetencat e organit doganor në lidhje me këtë taksë. | Qëllimi i këtij ligji është të rregullojë sistemin e tatimit të automjeteve në Maqedoninë e Veriut dhe kompetencat e organit doganor në lidhje me këtë taksë. | I ULËT | Ndikimi i këtij ligji në zbutjen e ndryshimeve klimatike është shumë domethënës, ndërsa potenciali i rezistencës është i papërfillshëm. |

| Dokumentet strategjike | | | Niveli | Përshkrimi |
|--|---|---|----------------|---|
| Strategjia Nacionale e Transportit 2018-2030 | SNT mbështet ambicien e RMV-së për integrimin në BE, nëpërmjet zhvillimit të një sektori të qëndrueshëm transporti, i cili është në përputhje me zhvillimin strategjik të vendit; e cila ka një infrastrukturë intermodale të integruar plotësisht në rrjetin evropian TEN-T; e cila menaxhohet sipas parimeve të qeverisjes së mirë duke respektuar të drejtën universale të "lëvizshmërisë" për të gjithë; dhe është e rregulluar siç duhet në përputhje me rregullat dhe rregulloret e BE-së, duke inkorporuar praktikat më të mira ndërkombëtare për zhvillimin e saj të mëtejshëm. | Strategjia Nacionale e Transportit mbulon konsideratat e ndryshimeve klimatike në këtë sektor. | I LARTË | - Masa Rregullative (MR) 5, 1.3. Amendimi i standardeve kombëtare të infrastrukturës së transportit në lidhje me përfshirjen e qëndrueshmërisë mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike. - Veprimi strategjik OSM 19 3.1. Përgatitja e një studimi gjithëpërfshirës për të përcaktuar ndikimet e ndryshimeve klimatike, ndryshueshmërisë së klimës dhe kushteve ekstreme të motit në infrastrukturë dhe shërbime (rezistenca e rrjetit). |
| Programi nacional për infrastrukturën hekurudhore për periudhën 2019-2021 | Programi nacional është një dokument që përcakton nevojat për ndërtimin, rikonstruksionin, remontin, modernizimin dhe mirëmbajtjen e funksionalitetit të infrastrukturës hekurudhore për një periudhë trevjeçare. Zhvillimi i infrastrukturës hekurudhore me cilësi të lartë dhe efikase në RM-ë duhet të jetë funksion i zhvillimit të qëndrueshëm dhe të balancuar të vendit. | Programi Kombëtar merr parasysh kontributin në ndryshimet klimatike dhe ndikimin e ndryshimeve klimatike dhe fatkeqësive të mundshme natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu në infrastrukturë dhe qasshmërinë për të gjithë përdoruesit e transportit. | I LARTË | Gjatë planifikimit të infrastrukturës, të gjithë pjesëmarrësit në krijimin e zhvillimit duhet t'i kushtojnë vëmendje vlerësimeve të rrezikut dhe masave të përshtatjes që kontribuojnë në mënyrë adekuate në rezistencën ndaj ndryshimeve klimatike dhe fatkeqësive mjedisore. |

Aktualisht, standardet teknike kombëtare dhe rregulloret në lidhje me infrastrukturën dhe kushtet hekurudhore janë pothuajse të njëjta me ato të aplikuara nga kompania hekurudhore e ish-Jugosllavisë. Kërkohe harmonizimi i standardeve dhe rregullave me direktivat dhe standardet teknike të BE-së.

Për sa i përket rëndësisë për hartimin dhe zhvillimin e infrastrukturës të transportit rezistent ndaj klimës, ekzistojnë disa iniciativa relevante në sektorin e transportit të pranishëm në Maqedoninë e Veriut, të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Tabela 4: Pasqyrë e iniciativave/projekteve/programeve më të rëndësishme [38]

| Iniciativa/projekte/programme | Relevanca për infrastrukturën rezistente ndaj klimës |
|---|---|
| <p>Projekti "Përmirësimi i performancës mjedisit jetësor dhe mbrojtjes së klimës së investimeve në infrastrukturë në rajonin e Ballkanit Perëndimor nga perspektiva e integritimit në BE" (CLIMAPROOF) financohet nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADC) dhe zbatohet nga Programi i OKB-së për Mjedisin Jetësor (2017-2021)</p> | <p>Projekti ClimaProof merret me një vlerësim gjithëpërfshirës të cenueshmërisë klimatike të sektorit rrugor në Maqedoninë e Veriut. Do të rezultojë në rritjen e kapaciteteve teknike të autoriteteve kombëtare përkatëse në fushën e mbrojtjes së klimës së infrastrukturës rrugore dhe infrastrukturës së gjelbër.</p> <p>Për projektet e mëdha të infrastrukturës, në fazën e planifikimit do të përgatiten projeksione të detajuara dhe specifike klimatike, të cilat do të mundësojnë integrimin e masave përshtatëse si në fazën e planifikimit ashtu edhe në fazën e zbatimit, duke maksimizuar kështu rezistencën ndaj ndryshueshmërisë klimatike dhe ngjarjeve ekstreme të motit.</p> |
| <p>Banka Botërore - Asistencë teknike për përgatitjen e udhëzimeve të projektimit për rezistencën klimatike për Ndërmarrjen Publike për Rrugët Shtetërore të Maqedonisë së Veriut - Udhëzimet e projektimit për elasticitetin klimatik (2019).</p> | <p>Udhëzimet ofrojnë instruksione të hollësishme dhe praktike se si të kryhet një vlerësim i cenueshmërisë dhe rrezikut të rrjetit rrugor ndaj ndryshimeve klimatike dhe rreziqeve natyrore. Metodologjia bën dallimin midis dy grupeve kryesore të aktiviteteve: i) vlerësimi i ndikimit të rrezikut dhe ii) identifikimi dhe prioritizimi i zgjidhjeve inxhinierike/jo-inxhinierike për reduktimin/zbutjen e rrezikut.</p> <p>Identifikimi i pjesëve rrugore me nevojën më kritike për ndërhyrje kryhet nëpërmjet katër hapave, të cilët përfshijnë nëntë detyra, që përfshijnë tre nivele: rrezikshmëria, rreziku, inspektimi inxhinierik dhe planifikimi. Udhëzimet përcaktojnë masat inxhinierike dhe jo-inxhinierike, si dhe rekomandimet institucionale dhe ligjore.</p> |
| <p>Projekti i detajuar dhe vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe social për autostradën A4, Shkup - Bllacë. Seksioni: Kycja Stenkovec-Pikëkalimi kufitar Bllacë (12.5 km) – Raporti i qëndrueshmërisë ndaj klimës (i financuar nga EBOR dhe EIB).</p> | <p>Raporti parashikon masa të adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike gjatë fazës së ndërtimit të rrugëve dhe gjatë fazës operacionale.</p> |

Megjithëse ballafaqimi me efektet e ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor ka përparësi ndaj veprimeve parandaluese, ka shembuj të praktikave të mira në përfshirjen e qëndrueshmërisë së infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore në projektet kapitale në Maqedoninë e Veriut. Për ndërtimin e disa pjesëve të autostradës mes Shkupit dhe Kosovës, Studimi për vlerësimin ndaj ndikimit mjedisit jetësor dhe aspektet sociale (VNMJAS) dha sugjerime se si rruga duhet të jetë rezistente ndaj ndryshimeve klimatike. Masat e propozuara duhet të përfshihen në projektin kryesor, kështu që kontraktori do të duhet t'i zbatojë ato gjatë ndërtimit. Ky është një shembull tjetër i një praktike të tillë, përveç studimit VNMJAS për autostradën Bukojčan-Kërçovë, studimi VNMJAS për rrugën shtetërore A3: seksioni Manastir-Pikëkalimi kufitar Mexhitlia, pastaj për rrugën shtetërore Strumicë-Valandovë: kryqëzimi me A1. Në transportin hekurudhor mund të përmendim Studimin e VNMJAS për ndërtimin e një hekurudhe të re në seksionin Kriva Pallanka - Kufiri me Republikën e Bullgarisë, si pjesë e Korridorit 8. Në të gjitha këto studime, planifikuesve të projektit bazë u rekomandohet të përdorin udhëzimet e zhvilluara dhe, nëse është e përshtatshme, të zbatojnë disa nga rekomandimet dhe masat për të reduktuar ndikimet negative në mjedis nga ndryshimet klimatike. Pra, tashmë ka praktikë pozitive në aplikimin e udhëzimeve për projektimin e infrastrukturës rezistente ndaj klimës, të hartuara për Ndërmarrjen Publike Rrugët Shtetërore.

8.3. Gjetjet kryesore dhe rekomandimet për sektorin e transportit

8.3.1. Gjetjet kryesore

Gjetja kryesore 1. Ekziston një objektiv i fortë strategjik nacional për mbrojtjen e klimës në sektorin e transportit.

Strategjia Nationale e Transportit 2018-2030 përmban objektiva të qarta për përfshirjen e standardeve dhe praktikave për mbrojtjen e klimës së infrastrukturës së transportit deri në vitin 2030.

Gjetja kryesore 2. Rrjeti rrugor është relativisht i pazhvilluar. Megjithatë, rrugët janë në gjendje mesatare, por shumica e rrugëve nuk i plotësojnë standardet bashkëkohore.

Infrastruktura ekzistuese e transportit kombëtar përbëhet nga pothuajse 15,000 kilometra rrugë publike. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, më pak se 50% e rrugëve janë në gjendje të keqe ose të kënaqshme.

Gjetja kryesore 3. Udhëzimet e projektimit për rezistencën ndaj klimës janë përgatitur për Ndërmarrjen Publike për Rrugët Shtetërore.

Këto udhëzime përfshijnë masat e përshtatjes klimatike, të cilat lidhen kryesisht me kullimin dhe specifikimet e ndërtimit, muret mbajtëse dhe stabilizimin e pjerrësisë. Udhëzimet mund të jenë gjithashtu të dobishme për rritjen e qëndrueshmërisë së llojeve të tjera të infrastrukturës. Rekomandohet që Ndërmarrja Publike Rrugët Shtetërore të vazhdojë zbatimin e këtyre udhëzimeve, përmes trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve të kompanive të ndërtimit dhe ekspertëve/inxhinierëve [38].

Gjetja kryesore 4. Kërkesat për qëndrueshmërinë klimatike të infrastrukturës së transportit nuk janë përfshirë mjaftueshëm në sistemin legjislativ.

Përdorimi i detyrueshëm i standardeve që kontribuojnë në rritjen e rezistencës mund të sigurohet duke vendosur detyrime për zbatimin e këtyre standardeve. Kjo mund të arrihet duke përfshirë standardet në ligjet dhe rregulloret përkatëse sektoriale.

8.3.2. Rekomandimet

Rekomandimi 1: Promovimi dhe përditësimi i udhëzimeve të projektimit të transportit ndërmjet sektorit publik dhe privat (komuna, inxhinierë, projektues dhe ekspertë të tjerë të transportit)

Elaborimi

Siç u theksua më parë, sektori i transportit në RMV-ë tashmë ka disa iniciativa përkatëse, si dhe një bazë të fortë, në Strategjinë e fundit Nationale të Transportit, për të rritur rezistencën e infrastrukturës së tij. Iniciativat përfshijnë projektin ClimaProof dhe Asistencën Teknike nga Banka Botërore për përgatitjen e udhëzimeve të projektimit për rezistencën klimatike për Ndërmarrjen Publike Rrugët Shtetërore. Këto iniciativa e njohin qartë rëndësinë e rezistencës klimatike të infrastrukturës në këtë sektor.

Qasja e mundshme

Qasja e mundshme është mjaft e qartë, pasi iniciativat e sipërpërmendura dhe korniza strategjike mbështesin zbatimin e aspekteve të rezistencës klimatike në këtë sektor. Kapaciteti që rezulton duhet të rritet dhe të merret parasysh në të gjitha projektet e ardhshme të infrastrukturës në sektorin e transportit. Megjithatë, një kornizë ligjore më e fortë, miratimi i standardeve më të fundit dhe koordinimi i përgjithshëm janë jetike që kjo të ndodhë [38].

Do të ishte gjithashtu shumë e dobishme të zhvillohen udhëzime për transportin hekurudhor të ngjashme me udhëzimet e zhvilluara nga Banka Botërore për transportin rrugor.

Është shumë e rëndësishme të sigurohet që udhëzime të tilla të zbatohen realisht në proceset e projektimit, ndërtimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës.

Zbatimi dhe afati kohor

Në [38] propozohet që Ministria e Transportit dhe Lidhjeve të organizojë trajnime deri në fund të vitit 2023 për inxhinierët e projektimit dhe ekspertët e transportit për të promovuar zbatimin dhe përdorimin e udhëzimeve të transportit rrugor të Bankës Botërore. Paralelisht, këto udhëzime mund të modifikohen bazuar në rezultatet e projektit ClimaProof dhe mund të merren parasysh udhëzime shtesë për mënyra të tjera transportit.

Rekomandimi 2: Inkurajimi i projekteve të transportit rezistente ndaj klimës dhe zgjidhjeve inovative të përshtatjes - transferimi i zgjidhjeve teknike më të mira ndërkombëtare të zbatueshme

Elaborimi

Ka shumë shembuj ndërkombëtarë të praktikave më të fundit. Një përvojë e rëndësishme është zhvilluar në sektorin e transportit, pasi shumë projekte përshtaten me ndikimet e parashikuara të ndryshimeve klimatike. Është e dobishme të merret në konsideratë transferimi i teknologjisë dhe njohurive në këtë drejtim.

Qasja e mundshme

Palët kryesore të interesuara mund të marrin në konsideratë zgjedhjen e aplikimit të metodologjive dhe zgjidhjeve teknike të ndryshme ndërkombëtare të zbatueshme dhe në dispozicion në lidhje me përshtatjen klimatike. Kjo mund të bëhet përmes projekteve pilot në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare dhe institucione akademike.

Transporti hekurudhor karakterizohet nga një infrastrukturë mjaft e vjetër dhe mjete lëvizëse. Duke pasur parasysh këtë, mund të jetë e këshillueshme që të nisen iniciativa që adresojnë në mënyrë specifike mbështetjen për zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore në të gjitha segmentet, me konsideratë të detyrueshme të rezistencës klimatike në proceset e projektimit, ndërtimit dhe prokurimit publik [38].

Zbatimi dhe afati kohor

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, në bashkëpunim me një organizatë/organizata ndërkombëtare, mund të shqyrtojë promovimin e zgjidhjeve inovative të projektimit rezistentë ndaj klimës në sektorin e transportit, bazuar në praktikat më të fundit ndërkombëtare [38]. Kjo mund të bëhet përmes ngjarjeve të ndryshme ndërgjegjësuese. Më tej, nëse ka iniciativa për modernizimin e hekurudhave, ministria e linjës mund të konsiderojë zbatimin e praktikave më të fundit ndërkombëtare.

Bashkëpërfitimet

- Përfshirja e sektorëve të inovacionit dhe akademike dhe mbështetje për zgjidhjet teknologjike të personalizuar, më të përshtatshme për vendin tonë.
- Infrastruktura cilësore e transportit ofron gjithashtu përfitime socio-ekonomike përmes sigurisë më të madhe, komoditetit më të madh, të ardhurave shtesë nga turizmi dhe vendeve të reja të punës.

9. TRANSPORTI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE NË STRATEGJINË AFATGJATE PËR VEPRIMIN KLIMATIK ME PLAN VEPRIMI

Si kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Republika e Maqedonisë së Veriut është e obliguar të transpozojë kornizën ligjore të BE-së në sistemin e saj juridik kombëtar, përkatësisht kornizën për klimën dhe energjinë në vitin 2030 dhe strategjinë afatgjatë për vitin 2050 dhe Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane.

Kjo strategji përcakton kontributin e RMV-së në përpjekjet globale, përmes rrugës drejt zhvillimit të gjellbër, me karbon të ulët dhe rezistent ndaj klimës, bazuar në informacionin më të fundit të disponueshëm dhe në kontekstin e anëtarësimin të vendit në BE. Vizioni për këtë strategji është si më poshtë: **Republika e Maqedonisë së Veriut deri në vitin 2050 është një ekonomi e begatë me karbon të ulët, e cila ndjek rrugë zhvillimi të qëndrueshme dhe rezistente ndaj klimës dhe forcon konkurrencën dhe promovon kohezionin social përmes veprimeve për të luftuar ndryshimet klimatike dhe ndikimet e tij [33].**

Trajtimi i ndryshimeve klimatike kërkon politika dhe masa në një gamë të gjerë sektorësh politikash, secili me një kontribut të saktë në arritjen e përgjithshme të angazhimeve nacionale për klimën. Prandaj, është e një rëndësie thelbësore që vizioni dhe objektivat e kësaj strategjie të integrohen në agjendat e ministrive përkatëse dhe të depërtojnë në politikat përkatëse sektoriale, nëpërmjet një koordinimi të forcuar horizontal të politikave. Ky imperativ për koordinim vlen edhe për cenueshmërinë e reduktuar nga ndikimet e ndryshimeve klimatike (përshtatja) dhe është i nevojshëm në nivel kombëtar, por edhe në nivele të ndryshme të administratës, përkatësisht në nivel të vetëqeverisjes lokale.

9.1. Objektivat specifike që lidhen me sektorin e transportit

Bazuar në gjendjen aktuale të ndryshimeve klimatike në RMV-ë, rezultatet e modelimit të emetimeve të gazrave serrë, duke përfshirë vlerësimin strategjik të ndikimeve në mjedisin jetësor duke marrë parasysh Marrëveshjen e Parisit për Klimën dhe Kornizën Klimatike dhe Energjitike të BE-së 2030, Vizioni strategjik evropian afatgjatë për një ekonomi të begatë, moderne, konkurruese dhe neutrale ndaj klimës, është përcaktuar objektiva e përgjithshme si në vazhdim [33]: *Reduktimi i emetimeve neto nacionale e gazrave serrë (duke përfshirë pylltarinë dhe përdorimin tjetër të tokës dhe duke përjashtuar MEMO) me 72% deri në vitin 2050 në krahasim me nivelin e vitit 1990 dhe rritja e rezistencës së shoqërisë, ekonomisë dhe ekosistemeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Emetimet MEMO përfshijnë emetimet e gazeve serrë nga aviacioni dhe importet e energjisë elektrike.*

Për të mbështetur përputhshmërinë me objektivin e përgjithshëm dhe zbatimin e masave sektoriale, objektivi i përgjithshëm ndahet në objektiva specifike zbutëse, përshtatjeje dhe të kryqëzuara. Në vijim janë paraqitur vetëm ato objektiva specifike që lidhen me sektorin e transportit.

Objektiva specifike zbutëse

Objektivat specifike zbutëse pasqyrojnë grumbullimin sektorial të emetimeve të gazeve serrë të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC) dhe për rrjedhojë, për aq sa është e mundur, korrespondojnë edhe me ndarjen e përgjegjësive për arritjen e objektivave specifike. I lidhur ngushtë me transportin është vetëm objektivi specifik zbutës 1.

Objektivi specifik 1: Për të reduktuar emetimet e gazrave serrë nga sektori i energjisë me 64% (duke përfshirë emetimet MEMO) deri në vitin 2050 krahasuar me 1990. Sektori i industrisë së energjisë do të arrijë reduktimet më të mëdha të emetimeve, përkatësisht përmes zbatimit të parimit "ndotësi paguan" (taksa e karbonit) dhe përmes rritjes së inputit të burimeve të rinovueshme të energjisë.

Zvogëlimi i emetimeve të gazrave serrë në sektorin e dytë më kontribues të emetimeve serrë – transportin, duhet të arrihet më së shumti duke rritur efikasitetin energjetik dhe duke rinovuar flotën e automjeteve. Në këtë kontekst, prezantimi i automjeteve hibride dhe elektrike do të luajë një rol të rëndësishëm, por në afat të shkurtër nuk është aq i rëndësishëm sa ulja e konsumit të karburantit të automjeteve tradicionale me djegie, të cilat deri në vitin 2030 do të mbeten automjeti tipik në RMV [33].

Objektivi specifik për përshtatje

Objektivi specifik për përshtatje që ka ndikim në përshtatjen e sektorit të transportit në lidhje me ndryshimet klimatike jepet më poshtë. Në kontekstin e përshtatjes, mund të përmendet analiza e paraqitur në kapitullin 8 për arritjen e infrastrukturës së transportit rezistent ndaj klimës.

Objektivi specifik 5: Të ndërtojë sisteme solide për mbledhjen e rregullt dhe periodike të të dhënave për prodhimin dhe shpërndarjen e njohurive shkencore dhe teknike. Sistemi i mbledhjes së të dhënave është dëshmuar të jetë çelësi për t'iu përgjigjur në mënyrë të përshtatshme dhe të menjëhershme efekteve të ndryshimeve klimatike. Kjo do të ketë një kontribut në identifikimin e nevojave për përshtatjen e infrastrukturës së transportit, si dhe për zbatimin e politikave, masave dhe aktiviteteve për zgjidhjen e këtyre nevojave.

Objektivat specifike horizontale/ndërsektoriale

Këto synime kanë të bëjnë me zhvillimin e bashkëpunimit ndërsektorial dhe forcimin e kapaciteteve të nevojshme për veprim në lidhje me ndryshimet klimatike. Realizimi i tyre do të kontribuojë gjithashtu në përmbushjen e plotë të aktiviteteve të planifikuara që duhet të ndërmerren në transport për të reduktuar sasinë e emetimeve të gazrave serrë.

Objektivi specifik 7: Të krijojë instrumente gjithëpërfshirëse për planifikimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave të veprimit për klimën. Kjo duhet të mundësohet nga një bazë ligjore gjithëpërfshirëse dhe instrumente koordinuese të krijuara ligjërisht për të lehtësuar hartimin dhe zbatimin e politikës ndërsektoriale, si dhe mekanizmat për monitorimin e zbatimit të politikave dhe masave të parashikuara.

Objektivi specifik 8: Aspektet kryesore që lidhen me ndryshimet klimatike në dokumentet e ardhshme nacionale të planifikimit strategjik lidhen me arsimin, kërkimin, zhvillimin dhe inovacionin, përfshirjen sociale dhe mundësitë e barabarta gjinore. Katër universitete publike dhe fakultetet e tyre, si dhe disa universitete private, kanë programe studimore deridiplomike dhe pasdiplomike në lidhje me ndryshimet klimatike dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Megjithatë, klima ende nuk është përfshirë siç duhet në sistemin e përgjithshëm arsimor nacional. Integrimi strategjik i ndryshimeve klimatike në të gjitha nivelet e sistemit arsimor duhet të përfshijë sigurimin e fondeve shtesë për aktivitetet kërkimore të lidhura me klimën, rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe ngritjen e qendrave të ekselencës dhe instituteve kërkimore.

Dokumentet më të rëndësishme strategjike nacionale që duhet të integrojnë aspekte të lidhura me klimën janë Strategjia e ardhshme Nacionale e Arsimit dhe Strategjia Nacionale e Inovacionit. Kjo do të sigurojë integrimin sistematik dhe të harmonizuar të aspekteve klimatike në sistemin arsimor nacional, kërkimin dhe zhvillimin, si dhe do të rrisë kapacitetet arsimore dhe kërkimore, si dhe ndërgjegjësimin e publikut të gjerë për klimën.

Objektivi specifik 9: Të promovojë tranzicionin e gjelbër përmes ndërtimit të kapaciteteve, trajnimeve për aftësi të reja dhe ndërgjegjësimit. Kalimi në një ekonomi me karbon të ulët bazohet në inovacionin teknologjik, në vendimet kryesore të investimeve dhe politikave, por gjithashtu bazohet në vendimet dhe sjelljen e individit qytetar. Qytetarët e mirëinformuar dhe të ndërgjegjshëm, të të gjitha moshave, kanë më shumë gjasa të angazhohen aktivisht në përpjekjet për të reduktuar emetimet e gazrave serrë. Ndërgjegjësimi për klimën është jashtëzakonisht i ulët në mesin e publikut të gjerë, por është i mjaftueshëm në nivel institucional[33]. Shkalla relativisht më e lartë e ndërgjegjësimit midis institucioneve mund të shpjegohet me përpjekjet e shumta të autoriteteve nacionale, komunitetit të donatorëve dhe organizatave joqeveritare, të cilat kanë punuar për çështjet e lidhura me klimën në vend për më shumë se 10 vjet.

Korniza e përgjithshme e ndryshimeve klimatike duhet të menaxhohet dhe monitorohet nga autoritetet kompetente, ku kërkohet rritje e konsiderueshme e kapaciteteve si parakusht për zbatimin e qëndrueshëm, monitorimin dhe raportimin e politikave dhe masave zbutëse.

9.2. Aktivitetet e propozuara në transport për zbatimin objektivit të zbutjes

Në vijim janë paraqitur aktivitetet e propozuara për reduktimin e ndikimeve klimatike nga sektori i transportit. Për çdo aktivitet jepet një pasqyrë tabelare me të gjithë informacionin e nevojshëm: lidhjen përkatëse me politikat e BE-së, dokumentet përkatëse kombëtare të planifikimit, ecurinë e zbatimit, si dhe organet përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin. Këto aktivitete janë të përcaktuara në Planin e Veprimit për fazën e parë të zbatimit të Strategjisë Afatgjatë dhe ligjit.

Aktiviteti 1: Shfrytëzimi më i lartë i hekurudhave [33]

| A-M-27: Shfrytëzimi më i lartë i hekurudhave | |
|---|--|
| Qëllimi kryesor: Përmirësimi i efikasitetit energjetikë në sektorin e transportit duke përdorur transportin hekurudhor më të lirë dhe më efikas. | |
| Periudha e zbatimit: | 2020-2040 |
| Lidhja me politikat e BE-së (aty ku është e rëndësishme): | Direktiva për promovimin e automjeteve të pastra dhe efikase energjetike për transportin rrugor 2009/33/EC Rregullorja për CO ₂ për makinat dhe furgonat 2009/443/EC |
| Dokumentet përkatëse nacionale të planifikimit, instrumentet ligjore dhe rregullatore: | - Strategjia nacionale për transportin - Strategjia për zhvillimin e sektorit të energjisë në RMV deri 2040 |

| | |
|---|---|
| Organi përgjegjës për zbatimin: | <ul style="list-style-type: none"> - Qeveria e RMV-së - Ministria e Transportit dhe Lidhjeve - Ministria e Ekonomisë, Agjencia e Energjetikës - SHA “Hekurudhat e Maqedonisë Transporti” - Shfrytëzuesit e fundit - Kompanitë private |
| Organi përgjegjës për monitorimin | Ministria e Ekonomisë, Agjencia e Energjetikës |
| Gazrat serrë të prekura (nëse është e aplikueshme) | 37.2 |
| Referenca në analizat dhe raportet teknike përkatëse | Strategjia e Energjetike deri në vitin 2040, PNEK, Raporti i Tretë Përditësues Dyvjeçar |
| Supozime/komente të përgjithshme | Deri në vitin 2040, 3% e kilometrave të makinave të udhëtarëve, 1% e kilometrave të autobusëve të udhëtarëve dhe 6.6% e kilometrave ton të automjeteve të rënda do të realizohen me transport hekurudhor. |

Aktiviteti 2: Rinovimi i flotës nacionale të makinave [33]

A–M–28: Rinovimi i flotës nacionale të makinave

Qëllimi kryesor: Përdorimi i teknologjive më të avancuara për të ngadalësuar konsumin në rritje të energjisë në sektorin e transportit, i cili është kompleks dhe me mundësi të kufizuara për të reduktuar përdorimin e energjisë.

| | |
|---|--|
| Periudha e zbatimit: | 2020–2040 |
| Lidhja me politikat e BE-së (aty ku është e rëndësishme): | <p>Direktiva për promovimin e automjeteve të pastra dhe efikase energjetike për transportin rrugor 2009/33/EC</p> <p>Rregullorja për CO₂ për makinat dhe furgonat 2009/443/EC</p> |
| Dokumentet përkatëse nacionale të planifikimit, instrumentet ligjore dhe rregullatore: | <ul style="list-style-type: none"> - Strategjia nacionale për transportin - Strategjia e Zhvillimit të Energjetikës së RMV-së 2040 - Ligji për automjetet - Ligji për tatim për automjetet |
| Organi përgjegjës për zbatimin: | <ul style="list-style-type: none"> - Qeveria e RMV-së - Ministria e Transportit dhe Lidhjeve - Ministria e Ekonomisë, Agjencia e Energjetikës - Shfrytëzuesit e fundit |
| Organi përgjegjës për monitorimin | Ministria e Ekonomisë, Agjencia e Energjetikës Ministria e Punëve të Brendshme |
| Gazrat serrë të prekura (nëse është e aplikueshme) | 43.1 |

| | |
|---|--|
| Referenca në analizat dhe raportet teknike përkatëse | <ul style="list-style-type: none"> - Ligji për automjetet (miratuar në gusht 2019) - Miratimi i akteve nënligjore të Ligjit për Tatimin e Automjeteve - Zbatimi i programit të subvencionimit për blerjen e automjeteve të përcaktuara në Ligjin për automjete - Përgatitja e një rishikimi të ligjit të akcizës (akcizat për karburantin dizel dhe benzinën duhet të barazohen gradualisht) |
| Supozime/komente të përgjithshme | Strategjia e Energjetike deri në vitin 2040, PNEK, Raporti i Tretë Përditësues Dyvjeçar |
| Periudha e zbatimit: | Supozohet se do të shiten vetëm automjete të reja jo më të vjetra se tetë vjet, pra automjete që plotësojnë standardet e BE-së. Teknologjitë e avancuara si automjetet elektrike hibride me naftë dhe benzinë do të përdoren me një pjesë prej 35% në totalin e kilometrave të makinave të udhëtarëve deri në vitin 2040. |

Aktiviteti 3: Rinovimi i flotës së mbetur të automjeteve kombëtare [33]

| A-M-29: Rinovimi i flotës së mbetur të automjeteve kombëtare | |
|---|--|
| Qëllimi kryesor: Reduktimi i ndotjes lokale | |
| Periudha e zbatimit: | 2020-2040 |
| Lidhja me politikat e BE-së (aty ku është e rëndësishme): | Direktiva për promovimin e automjeteve të pastra dhe efikase energjetike për transportin rrugor 2009/33/EC |
| Dokumentet përkatëse nacionale të planifikimit, instrumentet ligjore dhe rregullatore: | <ul style="list-style-type: none"> - Strategjia nacionale për transportin - Strategjia e Zhvillimit të Energjetikës së RMV-së 2040 - Ligji për automjetet - Ligji për tatim për automjetet |
| Organi përgjegjës për zbatimin: | <ul style="list-style-type: none"> - Qeveria e RMV-së - Ministria e Transportit dhe Lidhjeve - Ministria e Ekonomisë, Agjencia e Energjetikës - Kompani private |
| Organi përgjegjës për monitorimin | Ministria e Transportit dhe Lidhjeve Ministria e Ekonomisë, Agjencia e Energjetikës |
| Gazrat serrë të prekura (nëse është e aplikueshme) | 66.4 |
| Referenca në analizat dhe raportet teknike përkatëse | <ul style="list-style-type: none"> - Ligji për automjetet (miratuar në gusht 2019) - Miratimi i akteve nënligjore të Ligjit për Tatimin e Automjeteve - Zbatimi i njëpasnjëshëm i standardeve EURO (standard i ri i BE-së është EURO 6, ndërsa në RMV është EURO 4 për importin e automjeteve të reja me efikasitet energjetik) |

| | |
|---|--|
| Supozime/komente të përgjithshme | Strategjia e Energjetike deri në vitin 2040, PNEK, Raporti i Tretë Përditësues Dyvjeçar |
| Periudha e zbatimit: | Supozohet se do të shiten vetëm automjete të reja të avancuara si automjetet elektrike hibride që plotësojnë standardet e BE-së për emetimet e gazrave të shkarkimit |

Aktiviteti 4: Lëvizshmëria e avancuar [33]

| A-M-30: Lëvizshmëria e avancuar | |
|---|--|
| Qëllimi kryesor: Reduktimi i ndotjes lokale | |
| Periudha e zbatimit: | 2020-2040 |
| Lidhja me politikat e BE-së (aty ku është e rëndësishme): | |
| Dokumentet përkatëse nacionale të planifikimit, instrumentet ligjore dhe rregullatore: | <ul style="list-style-type: none"> - Strategjia nacionale për transportin - Strategjia e Zhvillimit të Energjetikës së RMV-së 2040 - Vendimet e komunave për subvencionimin e biçikletave të reja |
| Organi përgjegjës për zbatimin: | <ul style="list-style-type: none"> - Ministria e Ekonomisë, Agjencia e Energjetikës - Vetëqeverisja lokale - Shfrytëzuesit e fundit |
| Organi përgjegjës për monitorimin | Ministria e Ekonomisë, Agjencia e Energjetikës Vetëqeverisja lokale |
| Gazrat serrë të prekura (nëse është e aplikueshme) | 3.6 |
| Referenca në analizat dhe raportet teknike përkatëse | Strategjia e Energjetike deri në vitin 2040, PNEK, Raporti i Tretë Përditësues Dyvjeçar |
| Supozime/komente të përgjithshme | Deri në vitin 2040, 3% e kilometrave të udhëtarëve në distanca të shkurtra do të zëvendësohen nga ecja, përdorimi i biçikletave ose trotinet/skuterëve elektrikë. |

Aktiviteti 5: Ndërtimi i hekurudhës për në Republikën e Bullgarisë [33]

| A-M-31: Ndërtimi i hekurudhës për në Republikën e Bullgarisë | |
|--|---|
| Qëllimi kryesor: Lidhja e RMV-së me Republikën e Bullgarisë dhe rritja e eksporteve në tregjet e huaja, jo vetëm në vendet fqinje, por edhe në rajonin e Evropës Juglindore dhe Turqisë, nëpërmjet lidhjes hekurudhore. | |
| Periudha e zbatimit: | 2020-2040 |
| Lidhja me politikat e BE-së (aty ku është e rëndësishme): | |
| Dokumentet përkatëse nacionale të planifikimit, instrumentet ligjore dhe rregullatore: | <ul style="list-style-type: none"> - Programi i punës i Qeverisë së RMV-së - Strategjia Nacionale për Transportin |

| | |
|---|---|
| Organi përgjegjës për zbatimin: | - Qeveria e RMV-së - Ministria e Transportit dhe Lidhjeve - Ministria e Ekonomisë, Agjencia e Energjetikës |
| Organi përgjegjës për monitorimin | Ministria e Transportit dhe Lidhjeve Ministria e Ekonomisë, Agjencia e Energjetikës |
| Gazrat serrë të prekura (nëse është e aplikueshme) | 24.6 |
| Referenca në analizat dhe raportet teknike përkatëse | Strategjia e Energjetike deri në vitin 2040, PNEK, Raporti i Tretë Përditësues Dyvjeçar |
| Supozime/komente të përgjithshme | Deri në vitin 2040, deri në 5% të ton kilometrave në Republikën e Bullgarisë të mjeteve të rënda të mallrave do të zëvendësohen nga infrastruktura hekurudhore. |

Aktiviteti 6: Elektrifikimi i transportit [33]

| A–M–32: Elektrifikimi i transportit | |
|--|---|
| Qëllimi kryesor: Tranzicioni nga një shoqëri e bazuar në lëndë djegëse fosile në një shoqëri me karbon të ulët, ku burimet e rinovueshme të energjisë dhe elektrifikimi i transportit do të luajnë rolin më të rëndësishëm. | |
| Periudha e zbatimit: | 2020-2040 |
| Lidhja me politikat e BE-së (aty ku është e rëndësishme): | Direktiva për promovimin e automjeteve të pastra dhe efikase energjetike për transportin rrugor 2009/33/EC |
| Dokumentet përkatëse nacionale të planifikimit, instrumentet ligjore dhe rregullatore: | - Strategjia nacionale për transportin - Strategjia e Zhvillimit të Energjetikës së RMV-së 2040 - Ligji për automjetet - Ligji për tatim për automjetet |
| Organi përgjegjës për zbatimin: | - Qeveria e RMV-së - Ministria e Transportit dhe Lidhjeve - Ministria e Ekonomisë, Agjencia e Energjetikës |
| Organi përgjegjës për monitorimin | Ministria e Ekonomisë, Agjencia e Energjetikës Ministria e Punëve të Brendshme |
| Gazrat serrë të prekura (nëse është e aplikueshme) | 61.6 |
| Referenca në analizat dhe raportet teknike përkatëse | Strategjia e Energjetike deri në vitin 2040, PNEK, Raporti i Tretë Përditësues Dyvjeçar |
| Supozime/komente të përgjithshme | Parashikohet që deri në vitin 2040 pjesa e automjeteve elektrike dhe e mjeteve elektrike hibride "plug-in" në totalin e kilometrave të pasagjerëve të makinave të jetë 45%. |

Aktivitetet e paraqitura në sektorin e transportit, për shkak të shtrirjes më të madhe të ndikimit, kanë një periudhë më të gjatë zbatimi prej 20 vitesh, me afat deri në vitin 2040. Institucionet kryesore përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e tyre janë mbi të gjitha ministritë e linjës: MTL-ja dhe ME-ja me Agjencinë e Energjetikës. Pavarësisht periudhës së gjatë të zbatimit të të gjitha aktiviteteve, realizimi përfundimtar i tyre do të kontribuojë në zhvillimin e transportit të qëndrueshëm, i cili nuk do të jetë më ndër burimet kryesore nacionale të emetimeve të gazrave serrë. Zhvillimi i transportit të qëndrueshëm do të kontribuojë në tejkalimin e situatës aktuale serioze me moshën e flotës së automjeteve dhe përdorimin e lëndëve djegëse fosile, siç analizohet në kapitullin 5. Në këtë mënyrë do të arrihet një reduktim i emetimeve të gazrave serrë nga transporti dhe në këtë mënyrë të arrijë edhe zbutjen e ndryshimeve klimatike.

9.3. Koordinimi horizontal për zbatimin e objektivave

Zbatimi i politikave dhe masave të parashikuara në këtë strategji kërkon një proces gjithëpërfshirës për planifikimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave. Kjo duhet të mundësohet nga një bazë ligjore gjithëpërfshirëse dhe instrumente të përcaktuara ligjërisht për koordinim për të lehtësuar hartimin dhe zbatimin e politikës ndërsektoriale, si dhe mekanizmat për monitorimin e zbatimit të politikave dhe masave të parapara. Projektligji i veprimit për klimën ofron parakushte të favorshme për procese gjithëpërfshirëse të koordinimit të politikave dhe përcakton mekanizmin ligjor për monitorimin e progresit drejt arritjes së qëllimit kombëtar të zhvillimit të qëndrueshëm.

Përfshirja e klimës mund të mbështetet ndjeshëm nga fuqizimi i kapaciteteve institucionale dhe krijimi i mekanizmave të shëndoshë për bashkëpunim ndërsektorial. Aktualisht, kapacitetet klimatike të MMJPH-së janë të kufizuara, veçanërisht për sa i përket ekspertizës teknike për raportim tek organizatat ndërkombëtare, si dhe për monitorimin dhe raportimin mbi politikën, masat dhe projeksionet [33].

Vlerësimi i nevojave për kapacitete i kryer në Strategjinë Afatgjate tregoi se të gjitha ministritë përkatëse kanë nevojë për kapacitet dhe njohuri për të qenë plotësisht të afta për të integruar aspektet klimatike në planet dhe programet e tyre sektoriale. Kjo do të thotë që aspektet klimatike duhet të vendosen më lart në agjendën politike të Qeverisë në mënyrë që vendi të ndajë burime për të angazhuar kapacitete shtesë njerëzore në të gjitha nivelet. Përveç kësaj, është thelbësore të integrohen aspektet klimatike në dokumentet e ardhshme nacionale të planifikimit strategjik që lidhen me arsimin, kërkimin dhe zhvillimin dhe inovacionin.

Në kuadër të projektit "Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe teknike për përmirësimin e transparencës për ndryshimet klimatike në kuadër të Marrëveshjes së Parisit" është bërë vlerësimi i kapaciteteve administrative për trajtimin e ndryshimeve klimatike. "[Projekti CBIT- Capacity Building for Increased Capacities], implementuar nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor me mbështetje financiare dhe teknike nga GEF dhe UNDP. Në raportin e projektit [39], është bërë një propozim konkret për 8-10 vende të reja pune, gjysma e të cilave do të sistemohen në Departamentin për Ndryshimet Klimatike në MMJPH-ë, dhe gjysma tjetër në Departamentin e sapoformuar për Inventarin e Gazrave Serrë në kuadër të Qendrës Informative të Maqedonisë për Mjedisin Jetësor. Avantazhi i kësaj qasjeje është se të gjitha çështjet që lidhen me ndryshimet klimatike do të mbulohen brenda një njësie të vetme organizative nën mbikëqyrjen e drejtuesit të Departamentit

Në raportin e projektit [39], Ministria e Ekonomisë dhe Agjencia e Energjetikës janë identifikuar si institucione që do të luajnë një rol kyç në procese të caktuara ose në përpunimin e të dhënave për ndryshimet klimatike. E para ka një rol kyç në zhvillimin e planeve dhe raporteve për ndryshimet klimatike dhe energjitike, ndërsa e dyta është përgjegjëse për menaxhimin e sistemeve dhe platformave të informacionit për efikasitetin e energjisë. Prandaj, për këto dy institucione në [39] propozohen detyra shumë të detajuara pune, të cilat nuk nënkuptojnë se vendet e reja të punës duhet të sistemohen, por që ato mund të inkorporohen në vendet ekzistuese.

Zbatimi i një sistemi nacional administrativ të ndryshimeve klimatike kërkon burime të përshtatshme. Krijimi dhe mbajtja e marrëdhënieve të përshtatshme organizative, krijimi dhe përshtatja e flukseve të të dhënave, rekrutimi dhe ruajtja e ekspertizës, zhvillimi dhe vendosja e sistemeve dhe mjeteve, dhe ofrimi i rezultateve të reja, të gjitha kërkojnë planifikim të kujdesshëm dhe mirëmbajtje të burimeve [33].

Pra, është e qartë se ekziston nevoja për të forcuar kapacitetet institucionale dhe burimet njerëzore, veçanërisht në MMJPH-ë, për zbatimin e planeve dhe politikave me integrimin e aspekteve klimatike. Institucione të tjera, organe dhe autoritete sektoriale që kanë të bëjnë me ndikimet në emetimet e gazrave serrë mund të japin kontributin e tyre nëpërmjet një zhvillimi më efikas të koordinimit horizontal për realizimin e aktiviteteve të parashikuara në strategjinë e veprimit për klimën. Këtë e konfirmoi edhe punonjësi i Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve, i cili theksoi bashkëpunimin e vazhdueshëm me MMJPH-në në drejtim të ofrimit të të dhënave për aktivitetet dhe ndryshimet në zhvillimin e sektorit të transportit.

Nga pikëpamja që ka gjithmonë hapësirë për përmirësim të procesit, njohuritë e marra tregohen më në detaje në semaforin në Kapitullin 10.

Në vijim janë paraqitur aktivitetet që kanë efekt në forcimin e kapaciteteve dhe marrëdhënieve ndër-institucionale.

9.4. Aktivitete për forcimin e kapaciteteve institucionale

Aktivitetet e mëposhtme bazohen në planin e veprimit për forcimin e kapaciteteve administrative për aktivitetet klimatike. Plani i veprimit bën dallimin ndërmjet aktiviteteve për forcimin organizativ dhe strukturor dhe aktiviteteve për forcimin e kapaciteteve administrative. Plani i veprimit rekomandon veprime që lidhen me *organizimin dhe strukturën* e institucioneve përkatëse kombëtare të përfshira në veprimin për klimën.

Aktivitetet e propozuara përfshijnë riorganizime të brendshme dhe marrëdhënie ndër-institucionale për të siguruar bashkëpunimin dhe koordinimin e nevojshëm të autoriteteve dhe institucioneve qeveritare. Bashkëpunimi dhe koordinimi në Qeveri do të sigurohet përmes Këshillit Kombëtar për Nacional për Klimën të parashikuar në LVK dhe do të krijohet menjëherë pas miratimit të ligjit.

Aktivitetet për aranzhimet institucionale përfshijnë [33]:

- Të sigurojë përgjegjësi institucionale në veprimin për klimën me stafin e nevojshëm, të kualifikuar dhe sa më shumë që të jetë e mundur, një strukturë të veçantë për veprimin klimatik, qoftë sektor apo departament.
- Të sigurohet që secila prej këtyre strukturave të veprimit klimatik me një mandat të qartë dhe një përshkrim gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të detyrave dhe përgjegjësive, duke shmangur mbivendosjet dhe konfliktet e kompetencave me strukturat e tjera brenda të njëjtit institucion ose me institucione të tjera.
- Të sigurohet që secila prej këtyre strukturave të veprimit klimatik të ketë staf dhe të jetë e pajisur me burimet e nevojshme njerëzore, financiare dhe teknike, duke mbuluar të gjitha subjektet përkatëse që janë në kompetencat dhe funksionet e tyre (politikat, rregulloret, monitorimin, raportimin, ligjet dhe financat).
- T'u ofrojë institucioneve përgjegjësi në aktivitetet klimatike me mbështetje ligjore dhe financiare, nëpërmjet burimeve ose brenda sektorëve apo departamenteve të tyre nëpërmjet mekanizmave për bashkëpunim me strukturat e qeverisë qendrore.
- Kur detyrat në aktivitetet klimatike ndahen brenda një institucioni të caktuar, sigurohuni që të krijohen mekanizma komunikimi, koordinimi dhe bashkëpunimi.
- Të sigurohet që autoritetet kompetente të kenë qasje në ekspertizën shkencore, sipas nevojës.

Në vijim janë paraqitur aktivitetet për forcimin e kapaciteteve institucionale.

Aktiviteti 7: Krijimi i kapaciteteve organizative në institucionet relevante për veprimin klimatik [33]

| A–L–13: Krijimi i kapaciteteve organizative në institucionet relevante për veprimin klimatik | |
|--|---|
| Qëllimi kryesor: Mundësimi i institucioneve kompetente qeveritare për të krijuar kapacitetet organizative të nevojshme për të zbatuar veprimet klimatike. | |
| Periudha e zbatimit: | 2021-2025 (me rregullimet e mëpasshme) |
| Lidhja me politikat e BE-së (aty ku është e rëndësishme): | I gjithë legjislacioni i BE-së për ndryshimet klimatike |
| Dokumentet përkatëse nacionale të planifikimit, instrumentet ligjore dhe rregullatore: | - LVK dhe aktet nënligjore - Legjislacioni sektorial në lidhje me veprimin klimatik (primar dhe dytësor) |
| Organi përgjegjës për zbatimin: | - Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor - Ministrinë e sektorit |
| Organi përgjegjës për monitorimin | - Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor - Ministrinë relevante të sektorit - Organet e tjera shtetërore |
| Gazrat serrë të prekura (nëse është e aplikueshme) | Siç përcaktohet në legjislacionin e BE-së për veprimin klimatik dhe LVK |
| Referenca në analizat dhe raportet teknike përkatëse | Plani i veprimit për forcimin e kapaciteteve administrative për veprim klimatik |

Supozime/komente të përgjithshme

- Vullneti politik për zbatimin e aktiviteteve klimatike
- Burimet njerëzore dhe financiare
- Bashkëpunimi dhe koordinimi në ministri dhe organe shtetërore ndërmjet funksionimit të njësive përkatëse
- bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet të gjitha institucioneve relevante në funksionimin e Qeverisë

Aktivitetet e propozuara për të forcuar kapacitetet administrative përmes personelit adekuat për veprimin klimatik në institucionet e ndryshme përgjegjëse në këtë zonë bazohen gjithashtu në planin e veprimit për forcimin e kapaciteteve administrative të përmendura më sipër. Plani i veprimit identifikon të gjitha masat për të arritur kapacitetin e nevojshëm për të kryer detyrat e veprimit klimatik në institucionet përkatëse në RMV-ë. Si hap i dytë, u identifikuan dhe u propozuan me kalimin e kohës masat për forcimin e kapaciteteve të nevojshme në çdo institucion, me një periudhë projeksioni deri në 10 vjet, gjegjësisht deri në vitin 2030. Kjo pjesë e dytë e planit të veprimit është prezantuar këtu.

Aktiviteti 8: Ngritja e kapaciteteve të nevojshme të punonjësve në institucione për veprimin klimatik [33]

A-L-14: Ngritja e kapaciteteve të nevojshme të punonjësve në institucione për veprimin klimatik

Qëllimi kryesor: Sigurimi i burimeve të përshtatshme njerëzore në institucionet me detyra të veprimit për klimën.

| | |
|---|---|
| Periudha e zbatimit: | 2021-2025 (pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të LVK) |
| Lidhja me politikat e BE-së (aty ku është e rëndësishme): | Legjislacioni i përgjithshëm i BE-së për veprimin klimatik |
| Dokumentet përkatëse nacionale të planifikimit, instrumentet ligjore dhe rregullatore: | <ul style="list-style-type: none"> - LVK dhe aktet nënligjore - Legjislacioni sektorial në lidhje me veprimin klimatik (primar dhe dytësor) |
| Organi përgjegjës për zbatimin: | <ul style="list-style-type: none"> - MMJPH - ME - Ministria e Vetëqeverisjes Lokale - Komisioni Rregullativ për Energjetikën dhe Burimet Ujore - Zyra e Zëvendëskryeministrit - Ministria e Financave - Ministria e Shëndetësisë - Administrata për punë hidrometeorologjike - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave - MTLB - Ministria e Punëve të Brendshme - Inspektorati Shtetëror i Tregut - Enti Shtetëror Statistikor - Akademia e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë |
| Organi përgjegjës për monitorimin | Të gjitha institucionet, siç u tha më lart |
| Gazrat serrë të prekura (nëse është e aplikueshme) | Siç përcaktohet në legjislacionin e BE-së për veprimin klimatik dhe LVK |

| | |
|---|--|
| Referenca në analizat dhe raportet teknike përkatëse | Plani Veprimi për Forcimin e Kapaciteteve Administrative për Veprim Klimatik |
| Supozime/komente të përgjithshme | <ul style="list-style-type: none"> - Angazhimi politik dhe vullneti për të zbatuar veprimet për klimën - Institucionet dhe organet shtetërore përkatëse janë të përkushtuara për forcimin e kapaciteteve të punonjësve të tyre |

Aktiviteti 9: Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e legjislacionit mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike [33]

| A-L-15: Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e legjislacionit mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike | |
|---|--|
| Qëllimi kryesor: Të forcohen kapacitetet e të gjitha niveleve të administratës publike për të promovuar, monitoruar dhe zbatuar legjislacionin mjedisit jetësor dhe të ndryshimeve klimatike në RMV. | |
| Periudha e zbatimit: | 2022-2025 |
| Lidhja me politikat e BE-së (aty ku është e rëndësishme): | |
| Dokumentet përkatëse nacionale të planifikimit, instrumentet ligjore dhe rregullatore: | <ul style="list-style-type: none"> - Ligji për Veprim Klimatik - Aktet nënligjore për veprimin klimatik - Ligji për Mjedisin Jetësor - Legjislacioni sekondar për mjedisin jetësor |
| Organi përgjegjës për zbatimin: | MMJPH |
| Organi përgjegjës për monitorimin | MMJPH |
| Gazrat serrë të prekura (nëse është e aplikueshme) | CO ₂ , CH ₄ , N ₂ O |
| Veprimet për të mbështetur zbatimin e objektivit | <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i kornizës ligjore për mjedisin jetësor dhe klimën - Vlerësimi i kornizave nacionale ligjore dhe strategjike ekzistuese kundrejt politikave dhe masave më të fundit të BE-së për veprimin ndaj klimës - Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit nacional me legjislacionin e BE-së për klimën |

Kërkohej një angazhim i vazhdueshëm për përmirësimin e potencialit institucional të të gjitha organeve sektoriale që kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me veprimet klimatike, pavarësisht nëse ato përfshijnë në strukturën e tyre organizative një departament të veçantë për veprimin klimatik (ose përgjithësisht për mjedisin jetësor dhe zhvillimin e qëndrueshëm). Për shembull, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, siç tregohet nga një intervistë me punonjësën e saj, bashkëpunon në mënyrë aktive me MMJPH dhe institucione të tjera në ofrimin e të dhënave për sektorin e transportit, të cilat janë të nevojshme për analizën e ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Sigurisht, burimet njerëzore të organizuara në mënyrë efektive për mbledhjen e të dhënave statistikore për transportin, mbledhjen e informacionit, analizën, shkëmbimin e informacionit, të cilat nevojiten për menaxhimin dhe planifikimin në sektorin e transportit, do të kontribuojnë në rritjen e cilësisë së këtij procesi në të ardhmen.

10. SEMAFORI I PAJTUESHMËRISË

Semafori i pajtueshmërisë është një instrument/vegël që duhet të tregojë vizualisht gjendjen në një entitet të caktuar ose në këtë rast specifik - një sektori, gjegjësisht sektori i transportit. Gjendja është prezantuar në tre pjesë:

1

Pajtueshmëria strategjike

2

Kapacitetet organizative

3

Kryerja e detyrave për të arritur rezultate.

Semafori i shfaqur pajtueshmërisë ka për qëllim të tregojë se cila është gjendja nga pikëpamja formale dhe funksionale. Nëse konstatohen devijime më të mëdha, ato tregohen në shënime.

I. PAJTUESHMËRIA STRATEGJIKE

| | KRITERI | SEMAFORI | | | | | | SHËNIMET KRYESORE |
|---|--|----------|-----|---|-------------|-----|---|--|
| | | Formale | | | Funksionale | | | |
| | | x | +/- | √ | x | +/- | √ | |
| 1 | Rregullimi ligjor i detyrimeve për ndryshimet klimatike. | | | | x | | | Qeveria e RMV-së ka hartuar një projekt-ligj të veprimit për klimën më shumë se një vit më parë dhe ai ende nuk është miratuar nga Kuvendi i RMV-së. |
| 2 | Një drejtim strategjik i përcaktuar qartë për reduktimin e gazrave serrë në segmentin e transportit. | | | | | | | Lëvizshmëria e gjelbër dhe logjistika, me fokus në efektivitetin e mjedisit të sektorit të transportit, nuk janë futur ende. |
| 3 | Vendosja e detyrimit ligjor për përgatitjen e planit nacional për ndryshimet klimatike. | | | | | | | Ligji për Mjedisin Jetësor parashikon miratimin e një plani nacional për ndryshimet klimatike. |
| 4 | Vendosja e detyrimit ligjor për të përgatitur një inventar nacional të emetimeve antropogjene sipas burimeve dhe absorbuesve të gazrave serrë. | | | | | | | Ligji për Mjedisin Jetësor parashikon miratimin e një inventar nacional të emetimeve antropogjene sipas burimeve dhe absorbuesve të gazrave serrë. |

| | | | | |
|---|---|--|--|---|
| 5 | Përgatitja dhe miratimi i rregullt i Planit Nacional për Ndryshimet Klimatike. | | | Aktualisht është miratuar Plani i Katërt Nacional për Ndryshimet Klimatike. |
| 6 | Krijimi i bashkëpunimit institucional ndërmjet palëve përkatëse të interesit për ndryshimet klimatike. | | | |
| 7 | Reagimi në kohë i aktorëve përkatës ndaj ndryshimeve klimatike. | | | Nevojitet një koordinim më i madh ndërmjet aktorëve përkatës të ndryshimeve klimatike. |
| 8 | Është krijuar Inventari nacional të emetimeve antropogjene sipas burimeve dhe vendlëshimeve të gazrave serrë. | | | Është krijuar praktika për përgatitjen e inventarit nacional të emetimeve antropogjene sipas burimeve dhe vendlëshimeve të gazrave serrë. |

II. KAPACITETET ORGANIZATIVE

| | KRITERI | SEMAFORI | | | | | | SHËNIMET KRYESORE |
|---|---|----------|-----|---|-------------|-----|---|--|
| | | Formale | | | Funksionale | | | |
| | | x | +/- | √ | x | +/- | √ | |
| 1 | Ka ndarje të qartë, pra nuk ka mbivendosje në fushën e detyrave të punës ndërmjet subjekteve të ndryshme brenda sektorit. | | | | | | | Në subjekte të caktuara ka mbivendosje të përgjegjësiive. |
| 2 | Punonjësit brenda departamentit i kuptojnë funksionet bazë dhe strukturën organizative të institucionit. | | | | | | | |
| 3 | Vendet e punët kyçe (ato përmes të cilave arrihen qëllimet kryesore brenda sektorit) plotësohen me staf të përshtatshëm. | | | | | | | Inxhinierët e komunikacionit duhet të vendosen në poste të larta në sektorin e transportit, që në fakt është çështje e ligjeve të përgjithshme dhe të veçanta. |
| 4 | Menaxhmenti komunikon qartë planet e reformës, qëllimet strategjike dhe masat e përmirësimit tek punonjësit. | | | | | | | |

| | | | | |
|----|--|--|--|--|
| 5 | Të gjitha aktivitetet/detyrat e planifikuara në institucion realizohen. | | | Detyrat e punës kryhen në bazë të burimeve në dispozicion dhe përcaktohen kryesisht prej tyre. |
| 6 | Çdo punonjës kryen detyra që dalin nga vend përshkrimi i punës së tij. | | | Për t'iu përgjigjur kësaj çështje kërkohet një analizë funksionale e entiteteve brenda sistemit. |
| 7 | Nuk ka punë të sistematizuara brenda sektorit që janë të panevojshme. | | | Për t'iu përgjigjur kësaj çështje kërkohet një analizë funksionale e entiteteve brenda sistemit. |
| 8 | Punonjësit brenda sektorit në përgjithësi kanë kompetenca për përmbushjen e aktiviteteve dhe arritjen e qëllimeve strategjike. | | | Për t'iu përgjigjur kësaj çështje kërkohet një analizë funksionale e entiteteve brenda sistemit. |
| 9 | Punonjësit brenda sektorit kanë mundësi për zhvillim dhe trajnim profesional. | | | Për t'iu përgjigjur kësaj çështje kërkohet një analizë funksionale e entiteteve brenda sistemit. |
| 10 | Punonjësit brenda sektorit kanë mundësi për zhvillim dhe trajnim profesional. | | | Për t'iu përgjigjur kësaj çështje kërkohet një analizë funksionale e entiteteve brenda sistemit. |

III. KRYERJA E DETYRAVE PËR TË ARRITUR REZULTATE

| | KRITERI | SEMAFORI | | | | | | SHËNIMET KRYESORE |
|---|--|----------|-----|---|-------------|-----|--|-------------------|
| | | Formale | | | Funksionale | | | |
| | | x | +/- | √ | x | +/- | √ | |
| 1 | Brenda sektorit ka organizim adekuat, prioritizimin e qëllimeve. | | | | | | Për t'iu përgjigjur kësaj çështje kërkohet një analizë funksionale e entiteteve brenda sistemit. | |
| 2 | Vendimmarrja brenda sektorit bëhet përmes protokolleve të vendosura. | | | | | | Për t'iu përgjigjur kësaj çështje kërkohet një analizë funksionale e entiteteve brenda sistemit. | |
| 3 | Janë vendosur procedura të qarta me shkrim për proceset e punës. | | | | | | Për t'iu përgjigjur kësaj çështje kërkohet një analizë funksionale e entiteteve brenda sistemit. | |

| | | | | |
|---|---|--|--|--|
| 4 | Ekziston komunikim i mirë dhe i rregullt ndërmjet subjekteve brenda sektorit. | | | Për t'iu përgjigjur kësaj çështje kërkohet një analizë funksionale e entiteteve brenda sistemit. |
| 5 | Në nivel sektori, ekziston një sistem i vendosur i marrëdhënieve me publikun. | | | Për t'iu përgjigjur kësaj çështje kërkohet një analizë funksionale e entiteteve brenda sistemit. |

REKOMANDIME DHE PLANI PËR PËRMIRËSIMIN

I. PËRSHTATSHMËRIA E STRATEGJIKE

- Është e nevojshme miratimi i Ligjit për Veprimin Klimatik.
- Arritja e vazhdueshme e qëllimit të përcaktuar strategjik – futja e lëvizshmërisë së gjelbër dhe logjistikës, e fokusuar në efikasitetin ekologjik të sektorit të transportit dhe arritjen e rezultatit të pritur – reduktimin e emetimeve të serrave nga transporti me 15.1% në 2025 dhe me 18.6% në 2030.
- Forcimi i koordinimit të të gjitha palëve të interesuara në procesin e raportimit dhe informimit për gazrat serrë.
- Përpjekje të vazhdueshme për përgatitjen në kohë të dokumenteve nacionale për ndryshimet klimatike.

II. KAPACITETET ORGANIZATIVE

- Të bëhet një analizë funksionale e subjekteve individuale për të evidentuar kushtet në aktet ekzistuese për organizimin dhe sistemimin e brendshëm.
- Pozicionet kyçe të punës, veçanërisht pozitat drejtuese, duhet të plotësohen me persona me kualifikime të përshtatshme profesionale dhe përvojë pune.
- Të punohet në edukimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e shkathtësive të punës së punonjësve.

III. KRYERJA E DETYRAVE TË PUNËS PËR TË ARRITUR REZULTATE

- Nëse nuk janë krijuar, duhet të hartohen protokolle për proceset e punës dhe vendimmarrjes, pra procedura të qarta me shkrim për komunikimin ndërmjet subjekteve brenda sektorit.
- Nëse nuk janë krijuar, të zhvillohen protokolle për trajtimin e marrëdhënieve me publikun në nivel sektori.
- Të bëhet një analizë më e detajuar e situatës dhe nevojave me teknologjinë e TI-së, softuerin dhe mjetet e tjera të punës, si dhe stafin adekuat.
- Të përfitohet nga mundësitë e ofruara nga programet e BE-së dhe vendeve të tjera, si dhe organizatave të ndryshme për aplikim në projekte dhe veçanërisht për të zhvilluar anëtarët e stafit që do të monitorojë këto projekte dhe do të trajnohen siç duhet për t'i përdorur ato.

ANKESI 1

Analiza PESTLE

Për qëllime të këtij dokumenti është bërë një analizë që duhet të tregojë dhe parashikojë disa faktorë që kanë ndikim në sektorin e transportit.

Analiza PESTLE identifikon dhe analizon nxitësit kritikë të ndryshimit jashtë sektorit dhe paraqet një vlerësim për të marrë në konsideratë objektivin, karakteristikat ose planet. Mund të përdoret për të nisur formulimin e një strategjie ose për të rishikuar një strategji të tillë në mënyrë periodike duke rishikuar indikatorët. Kjo analizë është gjithashtu një mjet strategjik serioz jo vetëm për të gjithë sektorin, por edhe për subjektet individuale nga të cilat përbëhet.

Analiza PESTLE zakonisht aplikohet në gjashtë fusha (Fig. 11).




Fig. 11: Fushat në analizën PESTLE

Burimi: [27]

Për më shumë detaje në kuadër të kësaj analize, pyetjet dhe përgjigjet në të gjitha fushat janë dhënë më poshtë.

POLITIKE

• Cila është politika për ndikimin e transportit në ndryshimet klimatike?

✓ Duke u nisur nga fakti se Qeveria e RMV-së në të gjitha aktet ligjore parashikon miratimin e dokumenteve strategjike si për transportin ashtu edhe për ndryshimet klimatike, ekziston një lidhje formale mes këtyre dy sektorëve, por ajo funksionale nuk është e zhvilluar sa duhet.

• A ka politika për zbutjen e ndryshimeve klimatike një qasje gjithëpërfshirëse ndaj sektorit të transportit?

✓ Në kuadër të politikës për zbutjen e ndryshimeve klimatike, nuk është identifikuar një fokus i veçantë në sektorin e transportit.

EKONOMIKE

• Cili është parashikimi ekonomik?

✓ Niveli aktual i pasigurisë ekonomike, veçanërisht energjetike, është i pafavorshëm dhe si trend global. Energjia është shtytësi bazë në transport, por aktualisht nafta dhe benzina si karburantet më të përdorura kanë një çmim të lartë. Parashikimet nuk favorizojnë stabilizimin e çmimeve në të ardhmen e parashikueshme.

• A është kursi i këmbimit i luhatshëm ndaj ndryshimeve dramatike, të cilat mund të ndikojnë në sektor?

✓ Kursi i këmbimit është i qëndrueshëm.

• A mund t'i përballojnë përdoruesit produktet e ofruara nga sektori (gjegjësisht shërbimet e transportit)?

✓ Për shkak të krizës globale energjetike, shërbimet e transportit kanë një çmim më të lartë, ndaj nuk janë të përballueshme për të gjitha grupet sociale për të realizuar nevojat e tyre të përditshme të udhëtimit.

SOCIALE

• A ka rritje apo rënie të popullsisë në nivel shtetit?

✓ Në nivel të shtetit, statistikisht ka rënie të popullsisë.

• Cilat janë tendencat aktuale kulturore/sociale dhe a reflektohen ato në sektor

✓ Emigrimi është një nga kërcënimet më të mëdha dhe migrimi i brendshëm rural-urban është gjithashtu një trend që duhet theksuar.

• A i besojnë përdoruesit sektorit dhe shërbimeve të tij?

✓ Mund të konstatohet mosbesim për shërbimet e transportit në transportin rrugor dhe hekurudhor të udhëtarëve, sepse shërbimet nuk kanë cilësinë e duhur.

TEKNOLOGJIKE

- **Si është gjendja e teknologjisë brenda sektorit?**

- ✓ Sektori ka TI-në brenda kapaciteteve të zakonshme.

- **Sa shpejt zbatohen teknologjitë e reja në nivel sektori?**

- ✓ Teknologjitë e reja në nivel sektori nuk po zbatohen me shpejtësinë me të cilën ato bëhen të disponueshme.

LIGJORE

- **A është i rregulluar ligjërisht efekti i gazeve serrë?**

- ✓ Nuk ka asnjë akt ligjor gjithëpërfshirës në RMV që rregullon çështjet që lidhen me zbutjen e ndryshimeve klimatike. Prandaj, Qeveria ka propozuar Ligjin për Veprimin Klimatik, i cili ende nuk është miratuar nga Kuvendi i RMV-së.

- **A zbatohen ligjet dhe rregulloret që rregullojnë segmentin e gazeve serrë të sektorit të transportit?**

- ✓ Në thelb, ekziston një shkallë e caktuar e zbatimit të rregulloreve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë segmentin e gazrave serrë nga sektori i transportit, por jo të gjitha aktet janë miratuar pavarësisht se ekziston një detyrim për to, veçanërisht në pjesën e kategorizimit ekologjik të mjeteve në transportin rrugor.

MJEDISI JETËSOR

- **A kanë ndikim negativ në mjedisin jetësor disa shërbime që krijohen dhe ofrohen brenda sektorit?**

- ✓ Po, të gjitha shërbimet nga sektori i transportit kanë ndikim negativ në mjedisin jetësor dhe në emetimet e gazrave serrë.

- **A do të ndikojë ndryshimi klimatik në sektor?**

- ✓ Ndryshimet klimatike ndikojnë në sektor, pra në rezistencën e infrastrukturës së transportit.

Sipas kësaj analize, rezulton si në vijim:

Politike

RMV-ja i ndjek të gjitha detyrimet ndërkombëtare të ndërmarra nga ratifikimi i institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare në fushën e ndryshimeve klimatike. Megjithatë, përkundër vullnetit politik, RMV tashmë është vonë në rregullimin e çështjeve që lidhen me zbutjen e ndryshimeve klimatike, siç dëshmohet nga fakti se Projektligji për Veprim Klimatik u hartua në vitin 2022.

Ekonomike

Tendencat globale në ekonomi reflektohen drejtpërdrejt në nivel lokal. Kështu, çështjet financiare ndikojnë në sektorin dhe besimin e përdoruesve. Niveli aktual i pasigurisë ekonomike, veçanërisht energjetika, është i pafavorshëm dhe si trend global dhe për shkak të krizës globale energjetike, ka ndikim në rritjen e çmimit të shërbimeve të transportit.

Social

Nga pikëpamja e çështjeve sociale, vërehet një rënie e popullsisë, e cila demografikisht ka implikime në të gjithë sektorët, përfshirë këtu edhe transportin. Emigrimi është një nga kërcënimet më të mëdha dhe migrimi i brendshëm rural-urban është gjithashtu një tendencë e dukshme. Pasojat në sektorin e transportit mund të shihen në drejtim të uljes së numrit dhe frekuencës së linjave të transportit të pasagjerëve në trafikun periferik dhe ndërqytetës.

Teknologjike

Gjendja me TI-në është në nivel standard, duke marrë parasysh mundësitë e shoqërisë dhe shtetit në tërësi. Inovacionet e reja teknologjike, duke përfshirë TI-në, mund të avancojnë vetëm sektorin në tërësi.

Ligjore

Ndryshimet klimatike nuk janë të lidhura me legjislacionin nacional, por, duke marrë parasysh efektet e ndryshimeve klimatike, rregullimi është, para së gjithash, në nivel ndërkombëtar. Megjithatë, rregullorja mbi ndikimin e sektorit të transportit të gazit serrë duhet të rregullohet qartë dhe të përbëjë bazën e njohurive të këtij sektori për ndryshimet klimatike në RMV.

Mjedisi jetësor

Sektori i transportit ka një ndikim të rëndësishëm negativ në ndryshimet klimatike. Në nivel nacional, në sektorin e energjisë, transporti është burimi i dytë më i madh i emetimeve të gazrave serrë. Nga ana tjetër, ndryshimet klimatike kanë ndikim edhe në këtë sektor, veçanërisht në aspektin e qëndrueshmërisë së infrastrukturës së transportit.

LITERATURA

- [1] KUSHTETUTA E REPUBLIKËS MAQEDONISË SË VERIUT (GRMV nr. 52/1991, nr. 1/1992, nr. 31/1998, nr. 91/2001, nr. 84/2003, nr. 107/2005, nr. 3/2009, nr. 12.04.2011 dhe nr. 6/2019)
- [2] LIGJI PËR TRANSPORTIN NË KOMUNIKACIONIN RRUGOR ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 68/04, 127/06, 114/09, 83/10, 140/10, 17/11, 53/11, 6/12, 23/13, 120/13, 163/13, 187/13, 42/14, 112/14, 166/14, 44/15, 97/15, 124/15, 129/15, 193/15, 37/16, 71/16, 64/18, 140/18 dhe 163/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 275/19 и 67/22)
- [3] LIGJI PËR AUTOMJETET ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 140/08, 53/11, 123/12, 153/12, 70/13, 164/13, 138/14, 154/15, 192/15, 39/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 161/19)
- [4] Rregullore mbi informacionin në dispozicion të konsumatorit për konsumin e karburantit dhe emetimet e CO2 në lidhje me shitjen e automjeteve të reja të udhëtarëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 165/13)
- [5] LIGJI PËR SIGURINË NË KOMUNIKACIONIN RRUGOR ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 169/15 и 226/15)
- [6] STRATEGJIA NACIONALE E TRANSPORTIT 2018-2030
- [7] LIGJI PËR SISTEMIN HEKURUDHOR ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 48/10, 23/11, 80/12, 155/12, 163/13, 42/14, 130/14, 152/15, 31/16, 178/16 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 302/20)
- [8] Programi Nacional i Infrastrukturës Hekurudhore për periudhën 2014-2016 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 29/2014)
- [9] Programi Kombëtar i Infrastrukturës Hekurudhore për periudhën 2019-2021 ("Gazeta Zyrtare" nr. 122/2019)
- [10] LIGJI PËR AVIACIONIN ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 14/06, 24/07, 103/08, 67/10, 24/12, 80/12, 155/12, 42/14, 97/15, 152/15, 27/16, 31/16 и 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 220/19)
- [11] LIGJI PËR LUNDRIMIN NË BRENDESI TË VENDIT ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 55/07, 26/09, 22/10, 23/11, 53/11, 155/12, 15/13, 137/13, 163/13, 42/14, 166/14, 146/15, 193/15, 31/16 и 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 122/21)
- [12] LIGJI PËR CILËSINË E AJRIT TË AMBIENTIT ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/04, 92/07, 35/10, 47/11, 59/12, 163/13, 10/15 и 146/15 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/21)
- [13] LIGJI PËR MJEDISIN JETËSOR ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15, 39/16 dhe 99/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 89/22 dhe 171/22)
- [14] DRAFT-LIGJI I VEPRIMIT KLIMATIK
- [15] AKTI I AKCIZAVE („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 108/19, 143/19, 225/19, 275/19, 77/21 dhe 57/22)
- [16] LIGJI PËR TAKSAT E MJETEVE MOTORIKE ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 261/19)
- [17] Protecting the environment using human rights law

- [18] Uricchiov v. Italy and 31 Other States 2 (application no. 14615/21) and DeConto v. Italy and 32 Other States 3 (n° 14620/21)
- [19] Müllner v. Austria (no. 18859/21)
- [20] Green peace Nordic and Others v. Norway (no. 34068/21)
- [21] The Norwegian Grandparents' Climate Campaign and Others v. Norway (no. 19026/21)
- [22] Soubeste and four other applications v. Austria and 11 Other States 4 (nos. 31925/22, 31932/22, 31938/22, 31943/22 and 31947/22)
- [23] Engels v. Germany (no. 46906/22) Ankesa iu dorëzua Gjykatës në shtator 2022
- [24] Case C-330/18 Armando Carvalho and Others v European Parliament and Council of the European Union
- [25] Case C-366/10 Air Transport Association of America and Others v Secretary of State for Energy and Climate Change
- [26] Case C-203/12 Billerud Karlsborg AB and Billerud Skärblacka AB v Naturvårdsverket
- [27] Analiza e menaxhimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të pyjeve në RMV, shtator 2022, Dr. Zharko Aleksov dhe mr. Milorad Andrijeski
- [28] Rregullore për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor
- [29] Rregullore për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve
- [30] Raport për gjendjen e mjedisit jetësor, qasje me indikator 2020, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Qendra Informativë e Maqedonisë për Mjedisin Jetësor, RMV, f. 719.
- [31] Enti Shtetëror Statistikor i RMV-së, baza e të dhënave Maxstat, 2023.
- [32] Plani i Katërt Nacional i Ndryshimeve Klimatike, Raporti Nacional i Inventarit të Gazrave Serrë, RMV, Nëntor 2021, f. 240.
- [33] Strategjia afatgjatë e veprimit për klimën me plan veprim, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, RMV, f. 229.
- [34] Strategjia Nationale e Transportit 2018-2030, dhjetor 2018, f. 161.
- [35] Cilësia e mjedisit jetësor në RMV, Raporti Vjetor 2021, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, RMV, 2022, f. 149.
- [36] Strategjia nacionale për zhvillim të qëndrueshëm në Republikën e Maqedonisë pjesa I/II 2009-2030, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, RMV, 2010, f. 49.
- [37] Geveria e RMV-së, Plani Nacional i Energjisë dhe Klimës i Republikës së Maqedonisë së Veriut, draft version, SHPK Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), 2020, f. 183.
- [38] Study on the climate resilient infrastructure in the Republic of North Macedonia, E co. Ltd, UNDP North Macedonia, 2022, pp. 147.
- [39] Conducting Climate Change Administrative Capacity Assessment, Draft Report on Institutional Capacity Assessment, HEAT GmbH - Habitat, Energy Application & Technology, Germany, 2020, pp. 85.

